

Agjencia Kosovare e Pronës

Raporti Vjetor

2006



RAPORTI I PËRBASHKËT VJETOR 2006

DREJTORATI PËR ÇËSHTJE PRONËSORE DHE BANESORE

&

AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS

RISHIKIM I VITIT 2006

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave

Parathënie

Përmbledhje ezekutive

Kapitulli 1	MEKANIZMAT PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE PRONËSORE: DREJTORATI PËR ÇËSHTJE PRONËSORE - BANESORE DHE AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS
Kapitulli 2	PËRPUNIMI DHE SHQYRTIMI I KËRKESAVE PRONËSORE BANESORE TË PARAQITURA NË HPD
Kapitulli 3	ZBATIMI I VENDIMEVE TË HPCC-së
Kapitulli 4	PRONAT NËN ADMINISTRIM DHE SKEMA MBI QIRANË
Kapitulli 5	PERSONELI DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE
Kapitulli 6	AKTIVITETET PËR INFORMIM DHE SHPËRNDARJA E INFORMATAVE
Chapter 7	FINANCIMI
Kapitulli 8	NGJARJET KYÇE GJATË VITIT 2006
Kapitulli 9	VITI VIJUES

Shënim përmbyllës

Shtojcë – Anëtarët e Komisionit të Kërkesave Pronësore dhe Banesore

TABELAT E SHKURTESAVE

CCPU	Njësi Qendror për Përpunimin e Lëndëve , HPD
DCA	Departamenti i Administratës Civile, UNMIK
EAR	Agjencia Evropiane për Rindërtim
EU	Bashkësia Evropiane
fYROM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
HPD	Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore
HPCC	Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
IDP	Personat e Zhvendosur
KCA	Agjencia Kadastrale e Kosovës, IPVQ
KCB	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KFOR	Forcat e Kosovës, NATO
KPA	Agjencia Kosovare e Pronës
KPCC	Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës, KPA
KPS	Shërbimi Policor i Kosovës, UNMIK
KTa	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, UNMIK
NGO	Organizata Jo-Qeveritare
OLA	Zyra e Këshilltarit Juridik, UNMIK
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PISG	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse
SRSg	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve
UN-Habitat	Programi i Kombeve të Bashkuara mbi Strehimin e Njerëzve

UNHCR	Komisioneri i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë.
UNOB	Zyra e Kombeve të Bashkuara në Beograd

PARATHËNIE

Nga Z. Knut Rosandhaug,

*Drejtor Ekzekutiv i Drejtoratit për Çështje Pronësore dhe Banesore
Drejtor i Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës*

Për ish Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore (HPD), dhe pasardhësin e tij, Agjencin Kosovare të Pronës (“KPA”), viti 2006 ishte vit i shpërndarjes së mirëfilltë, i suksesit të dukshëm dhe i sfidave të reja.

E mandatuar në vitin 1999 nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (“PSSP”) në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 me rolin udhëheqës në çështjet lidhur me zgjidhjen e kontesteve pronësore dhe banesore, besoj se HPD-ja ia doli mbanë me këtë sfidë. Në përfundim të vitit 2006, HPD-ja në mënyrë të shpejtë përfundoi zgjidhjen e rreth 29, 160 kërkesave pronësore dhe banesore të paraqitura nga refugjatët dhe personat e zhvendosur (“IDP”). Procesi ka ndryshuar humbjen diskriminuese që kanë ndodhur ndërmjet vitieve 1989 dhe 1999, ka rregulluar shitjet jo zyrtare të pronave duke ua kthyer posedimin e pronës personave të zhvendosur nga konflikti.

Përmes zbatimit të mandatit të saj, HPD-ja ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në ndërtimin e paqes dhe në mbrojtjen e të drejtave të pronës në Kosovë. Kontributi i saj pozitiv është bërë i njohur gjerësisht në falenderimet publike nga udhëheqësia e UNMIK-ut, UNDP, UNHCR, OSBE, EU, zyret diplomatike dhe shumë të tjera, ku të gjitha kanë përkrahur punën e saj, sukseset duke konsideruar se ka dhënë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e trajektorës pozitive për Kosovën. Më tej, vlerësimi i jashtëm dhe frekuenca me të cilën janë kërkuar përvojat dhe pikëpamjet e menaxhmentit të HPD/KPA-së mbi çështjet e të drejtave pronësore nga vepruesit tjerë kyç në fushën e të drejtave pronësore në tërësi, demonstrojnë mbi respektin e lartë të cilën HPD-ja gëzoi.

Njohja publike e kontributit të HPD-së nuk është e kufizuar vetëm në kontributin e saj në ndërtimin e paqes në Kosovë. Modeli i HPD-së është marrë si model për zgjidhjen e kontesteve pronësore në skenaret e pashpresa siç janë ai i Irakut, Qipros, Gjeorgjisë dhe Palestinës përveç tjerash. Kjo si rezultat solli zhvillimet legjislative të marsit 2006 në të cilën UNMIK-u transformoi HPD-në si tërësi, personelin e saj dhe pasuritë fizike në një agjenci të re të pavarur, Agjencia Kosovare e Pronës (“KPA”) duke i dhënë asaj mandat për të zgjidhur kontestet mbi pronën bujqësore dhe komerciale¹. Kjo qasje siguroi që zbatimi, metodologjisë dhe procedurave efikase të njohura që u shfrytëzuan nga HPD-ja më parë të aplikohen në përpunimin e kërkesave për toka bujqësore dhe komerciale. KPA-ja gjithashtu u ngarkua me përgjegjësinë për zbatimin e kërkesave pronësore dhe banesore të HPD-së që nuk janë zgjidhur dhe menaxhimin e pronave nën administrimin e HPD-së. Vetëm rreth 2.6% të vendimeve mbi kërkesat ishin në pritje të zbatimit në fund të vitit 2006 dhe këto vendime KPA-ja do t’i zbatoj në çerekun e parë të vitit 2007. Në pajtim me kompetencat e saja për të marrë menaxhimin portfolios së pronave administrative të HPD-së, KPA-ja në fund të vitit 2006 ka menaxhuar diku 5,257 prona. Përveç kësaj, në prill të vitit 2006 pasi që UNMIK-u aprovoi skemën e qirasë për këto prona, dhe pas miratimit të saj nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (“IPVQ”) në gusht KPA-ja sajoi dhe zbatoi një skemë të tillë, duke u siguruar burime të ardhurash bartësve të zhvendosur të së drejtës pronësore, të cilët aktualisht nuk dëshirojnë të ushtrojnë të drejtën e tyre për kthim në shtëpitë e tyre apo për shitjen e tyre.

Për vitin 2007 janë caktuar caqe të reja dhe ambicioze për zbatimin e ri të mandatit të KPA-së. Besoj se institucioni i ri do të mund ta shfrytëzojë përvojën e mësuar nga procesi i HPD-së, dhe ekspertiza dhe shënimet e stafit të saj të dëshmuara dhe menaxhmenti për t’u marrë me efikasitet me sfidat me të cilat pashmangshëm do të ballafaqohet gjatë implementimit të mandatit të saj. Më tutje, KPA do të ngritet mbi arritjet e HPD-së në zgjidhjen e kontesteve pronësore – çështje vendimtare për Kosovën.

¹ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2006/10 e cila ishte nxjerrur më 4 mars 2006.

Dëshiroj të falenderoj personelin e HPD/KPA, të cilët punuan në mënyrë shumë të zellshme gjatë mandatit të HPD-së dhe u angazhuan në mënyrë aktive për të siguruar që institucioni të arrij qëllimet e veta. Ata punuan me përkushtim dhe vazhduan përkundër pasigurisë serioze lidhur me punësimin e tyre dhe të ardhmën e institucionit gjatë gjithë vitit 2005 dhe fillimit të vitit 2006. Unë vendosmërisht falenderoj dhe çmoj iniciativën dhe kontributin e tyre në punën e HPD-së dhe mirëpres angazhimin e ngjashëm në procesin e KPA-së.

Gjithashtu falenderoj përfshirjen dhe përkrahjen e shtuar të IPVQ-së ndaj HPD-së në të kaluarën dhe i ftoj ata të na mundësojnë një nivel të shtuar të mbështetjes të procesit të KPA-së. Përveç kësaj, falenderoj për vullnet të mirë dhe kooperimin të ngushtë në të cilën HPD-ja, dhe që nga themelimi, KPA-ja, kanë marrë nga autoritetet në Beograd. Të dy institucionet gëzojnë qasje të papenguar në të dhënat e pronës atje. Pastaj, autoritetet kanë mbështetur në mënyrë aktive shumë fushata informative publike të filluara në të gjitha vitet e operimit të HPD-së, dhe së fundi në nëntor të vitit 2006 kur KPA-ja filloi fushatën e vet gjithëpërfshirëse.

Dëshiroj të falenderoj të gjithë donatorët tanë për mbështetjen e tyre të dobishme financiare dhe te pavarur ndaj HPD-së dhe kohën e fundit ndaj KPA-së. Dëshiroj të shfrytëzoj këtë rast që t'u apeloj atyre për vazhdimin e mbështetjes së tyre KPA-së. Mbështetja e procesit do të sigurojë kthimin e të gjitha pronave private bartësve të ligjshëm të së drejtës pronësore, dhe e tërë kjo është thelbësore për pajtim, kthim të qëndrueshëm, rilindje ekonomike dhe rritje në Kosovë.

Përfundimisht në këto rrethana, më duket e rëndësishme të kujtoj dhe të cek që mekanizmi i kthimit të pronës, sikurse HPD-ja apo KPA-ja, vetë, pa marrë parasysh sa është efikase, vetëm nuk mund të sigurojë kthim të popullatës të zhvendosur. Zgjidhja e pronës kontestuese dhe kthimi i pronës është vetëm një aspekt i kthimit. Është e qartë se procesi nuk mund të merret me një spektër të gjërë të çështjeve përkatëse që duhet të adresohen në mënyrë aktive me qëllim të sigurimit të kthimit të sigurtë (d.m.th. qasje në shërbime, punësim dhe veprimtari për krijimin e të hyrave, sigurim, lëvizje të lirë dhe

ndërtim të shtëpive të shkatërruara për të përmendur disa prej elementeve më themelore). Prandaj, unë mirëpres iniciativa të përbashkëta dhe të ndërlidhura që kanë për qëllim adresimin e këtyre çështjeve. Ne në KPA jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me aksionar të ndryshëm për t'i kontribuar një qasjeje të tillë gjithëpërfshirëse. Në mungesë të një qasjeje të tillë, kthimi nuk do të jetë i realizueshëm dhe as i qëndrueshëm, dhe ekziston rreziku që HPD-ja, si dhe KPA-ja, pas përfundimit të zbatimit të mandatit të tyre përkatës të “*fajësohen*” gabimisht për mungesë të kthimit fizik dhe të dukshëm.

Me mirënjohje për përkrahjen tuaj të vazhdueshme për KPA-në.

Knut Rosandhaug

Drejtore

Dhjetor 2006

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Dekada e fundit ka dëshmuar përparim të rëndësishëm të të drejtave të njeriut në mbrojtje të gëzimit të të drejtave të pronës. Shkeljet e të drejtave të pronës dhe kthimi për refugjatët dhe personat e zhvendosur ju është dhënë vemendje e shtuar nga komuniteti ndërkombëtar në kontekst të ndërtimit të paqes së pas konfliktit. E drejta e refugjatëve dhe personave të zhvendosur (IDP) për të u kthyer në shtëpitë e tyre dhe vendet e banimit në vendet e tyre apo vendin e origjinës, pas krizave të refugjatëve ka zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme normën e të drejtave të njeriut. Më pastaj, Operacionet Paqeruajtëse ndërkombëtare i konsiderojnë këto çështje si komponente qendrore të përpjekjeve të ndërtimit të paqes, dhe në mënyrë të domosdoshme rilindjen ekonomike dhe kthimin e qëndrueshëm. Mekanizmat ligjorë që rrethojnë organet kuasi gjyqësore kanë mandatë të dresojnë çështjet pronësore dhe kontestet kanë përcaktuar në veqanti kontekstet kombëtare nga Operacionet Paqësore të UN-it për të ndihmuar personat e zhvendosur të kthehen në shtëpitë e tyre dhe atje është paraqitur një e drejtë e qartë për të zhvendosurit në kthim të të drejtave të pronës. Kosova është një regjion i tillë ku UN-i ka angazhuar në mënyrë efikase çështjen e të drejtave pronësore.

Brenda pesë muajve të hyrjes në Kosovë, Misioni i Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK”) në vendosjen e prioritetit të lartë në kthimin e refugjatëve dhe të zhvendosurve, ka themeluar një mekanizëm të pavarur i cili ka pasur mandat të sigurojë zgjidhje të shpejtë të kontesteve pronësore dhe banesore; të ndalë në përgjithësi uzurpimin e pronave ilegale dhe çështjet tjera në sektorin e banimit. Nën Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23 Drejtorati për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (HPD) dhe organi i saj i pavarur kuasi gjyqësor i Komisionit të Kërkesave Pronësore dhe Banesore (“HPCC”) ishte themeluar dhe kishte mandat *“të arrijë një zgjidhje efikase dhe efektive të kërkesave lidhur me pronën banesore”*.²

² Shih Parathënien e Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

Pjesa kryesore e punës së HPD-së ishte të mbledhë dhe përpunojë kërkesat e pronave banesore për t'ia paraqitur Komisionit që është themeluar si organ kuasi-gjyqësor për të gjykuar këto konteste. HPCC-ja ka gjykuar 179 kërkesat e mbetura në shkallën e parë në seancën e tetorit 2006, duke kryer kështu gjykimin e diku 29,160 kontesteve pronësore dhe banesore. Vendimet në të gjitha rastet prej 29,160 janë lëshuar dhe u janë dorëzuar palëve në kërkesë. HPCC-ja ka gjykuar gjithashtu 2,441 kërkesa për rishqyrtim në vendimet e shkallës së parë gjatë vitit 2006 dhe do t'i gjykojë 335 kërkesa që janë në pritje në seancat e ardhshme gjatë vitit 2007.

Sa i përket implementimit të të gjitha vendimeve të HPCC-së, 2.5% (721) vendime janë implementuar në tërësi në fund të vitit 2006. Ato implementime që janë në pritje do të implementohen në çerekun e parë të vitit 2007 në pajtueshmëri me zgjidhjen e paraqitësit të kërkesës për implementim të vendimit (d.m.th. riposedim, vendosja e pronës nën administrim të përkohshëm apo mbyllja e dosjes së kërkesës). Vëmendje e posaçme do t'i kushtohet gjithashtu implementimit të diku 258 vendimeve të HPCC-së ku kompensimi monetar është dhënë në dobi të paraqitësve të kërkesave në bazë të nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

Implementimi i aspektit të pronës administrative të mandatit të pronës banesore ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2006 me një numër të përgjithshëm të pronave prej 5,257 nën administrim në fund të vitit 2006. Diku 1,845 të këtyre pronave ishin marrë nga HPD-ja *ex officio* (prej marsit 2006 nga KPA) nën administrimin, derisa 3,412 kanë qenë në bazë të kërkesave nga paraqitësit e suksesshëm të kërkesave të cilët nuk kanë dashur të riposedojnë shtëpitë e tyre. Vëmendje e posaçme gjatë gjithë vitit i është kushtuar projektimit dhe implementimit të skemës së qirasë për pronat nën administrim, pas aprovimit të një skeme të tillë nga PSSP dhe IPVQ. Skema e qirasë e cila është përdorur prej tetorit 2006, ua mundëson paraqitësve të kërkesave të cilët vendosin pronën e tyre nën administrim që ta japin atë me qira, duke siguruar kështu një burim të të ardhurave nga prona si dhe duke ofruar alternativa për shitje.

Zhvillimet legislative në vitin 2006 për të përdorur metodologjinë e HPD-së për t'i shqyrtuar kërkesat mbi kontestet e pronës private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, kanë rezultuar me ndryshime të mëdha të HPD-së. Gjatë viteve paraprahe është zhvilluar një seri e gjatë e diskutimeve dhe debateve rreth mënyrës në të cilën zgjidhja e kërkesave të tilla do të duhej arritur duke e arritur kulminacionin në mars 2006 me nxjerrjen e Rregullores së UNMIK-ut 2006/10. Rregullorja në mënyrë efikase e ka transformuar HPD-në në një agjenci të re, Agjencia Kosovare e Pronës ("KPA") dhe stafin e saj, mjetet themelore dhe tërë organizata është transformuar në një agjenci të re. KPA-ja merr përgjegjësi për sasinë e punëve të HPD, për të përfshirë implementimin e vendimeve të HPCC-së që janë në pritje si dhe menaxhimin e pronës në administrim të HPD. Sidoqoftë, puna kryesore e Agjencisë së re është të sigurojë një zgjidhje të suksesshme dhe efektive të kontesteve pronësore lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale. Politika e KPA-së është të ofrojë një forum joformal, të kuptueshëm, jo të shtrenjtë, të shpejtë e të arsyeshëm për zgjidhje të shpejtë të volumit të lartë të kërkesave të pronës së paluajtshme. KPA përbëhet prej tri organeve kryesore, Bordi Mbikqyrës, Sekretaria ekzekutive dhe Komisioni Autonom i Kërkesave Pronësore të Kosovës. Sekretaria ekzekutive do t'i ofrojë ndihmë sekretarie Komisionit i cili do t'i gjykojë kërkesat. KPA funksion në mënyrë të pavarur nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes si organ i pavarur në bazë të Kapitullit 11.2 të Kornizës Kushtetuese, përmes ndihmës nga Bordi Mbikqyrës. Komunitetit donator si bashkë me UNMIK-un si dhe përfaqësuesit e komuniteteve shqiptare dhe serbe janë të gjithë të përfaqësuar në Bord.

Gjatë gjithë vitit 2006, përveç përfundimit të mandatit të pronave banesore, një vëllim genësor i punës është ndërmarrë me qëllim të fillimit të zbatimit të mandatit të pronave komerciale dhe bujqësore. Pranimi i kërkesave ka filluar në Kosovë në prill 2006, në Serbi në korrik 2006 dhe në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Mal të Zi në shtator 2006. Notifikimi i kërkesave mbi pronat dhe verifikimi i dokumenteve ka filluar në vjeshtë të vitit 2006. Deri tani nuk është përcaktuar ndonjë afat kohor lidhur me përfundimin e pranimi të kërkesave.

KPA-ja gjithashtu ka krijuar imazhin/llogon e vet të korporatës. Faqja e saj e internetit u lëshua në prill të vitit 2006, dhe informatat u shpërndanë përmes takimeve publike dhe intervistave në media. Pastaj filloi një fushatë informative publike gjithpërfshirëse në nëntor. Përveç kësaj, janë mbajtur takime të rregullta me përfaqësuesit e komunitetit minoritar, IPVQ-të, OJQ-të dhe faktorët tjerë kyç në fushën e të drejtës pronësore. Në pranverë të vitit 2006 KPA ka ndërmarrë iniciativë rekrutimi dhe prokurimi për automjetet shtesë dhe pajisjet e teknologjisë informative si dhe burimeve, përveç zgjerimit të rrjetit të vet të zyreve në Serbi për të lehtësuar pranimin e kërkesave.

Përveç kësaj, në vjeshtë të vitit 2006, KPA-ja hartoi një Urdhëresë Administrative në konsultim me subjektet e tjera kyçe e cila iu përcoll Këshilltarit Juridik në Zyrën e UNMIK-ut duke përcaktuar hollësisht rregullat e procedurës për përpunim, shqyrtim dhe zbatim të kërkesave që i përkasin mandatin të KPA-së.

Në aspektin financiar viti 2006 ka qenë një vit i kërkesave meqenëse duhej të investoheshin përpjekje të mëdha nga menaxhmenti i KPA-së në gjetjen e fondeve të nevojshme për procesin. Kjo ka përfshirë takimet me të gjithë përfaqësuesit diplomatikë në Kosovë dhe duke organizuar takime për donatorë. Takimi i donacionit ishte mbajtur në nëntor i cili ishte kryesuar nga Kryesuesi i Bordit Mbikqyrës të KPA-së, ZPSSP duke nënvizuar mandatin i agjencisë së re dhe rëndësinë e saj për ndërtim të paqes dhe ringjalljen ekonomike në Kosovë. Deri më tani për këtë proces janë premtuar 7 milion euro. Shpenzimi i paraparë për tërë operimin shtrihet diku rreth 15 milion € për diku 11,000 kërkesa të parashikuara.

Agjencia Kosovare e Pronës, e cila përfiton nga përvoja dhe ekspertiza e HPD-së në zgjidhjen e kontesteve pronësore, ka potencial që të ngritet në bazë të të arriturave të HPD-së, dhe të arrijë një zgjidhje të drejtë dhe me kosto efektive të të drejtave pronësore si dhe në mënyrë të shpejtë të dorëzojë rezultatet e qarta mbi standardet e të drejtave të Agjencisë Kosovare të Pronës- megjithatë vetëm përmes nivelit të duhur të fondeve të mundshme.

KAPITULLI 1

MEKANIZMAT PER ZGJIDHJEN E KONTESTEVE PRONËSORE: DREJTORATI PËR ÇËSHTJE PRONËSORE DHE BANESORE DHE AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS

1.1 Parathënie

Qasja e UNMIK-ut për t'u marrë me çështjen e shkeljeve të të drejtave pronësore në Kosovë ka qenë gjithëpërfshirëse. Brenda pesë muajve të hyrjes në Kosovë, themeloi një organ të pavarur, Drejtoratin për Çështje Pronësore dhe Banesore ("HPD") për të zgjidhur kërkesat mbi pronën banesore. Pastaj në mars të vitit 2006 një institucion i ri, Agjencia Kosovare e Pronës ("KPA") ishte krijuar me mandat për të zgjidhur kërkesat mbi pronën e paluajtshme, duke përfshirë pronën komerciale dhe bujqësore. Themelimi dhe mandati i këtyre institucioneve të pavarura përkatëse shqyrtohen këtu.

1.2 Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore (HPD)

1.2.1 Themelimi dhe mandati

HPD-ja u themelua në nëntor të vitit 1999 në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe kishte mandat për të "ofruar udhëzim të përgjithshëm mbi të drejtat e pronës në Kosovë derisa Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të përcaktojë që institucionet lokale të qeverisjes të jenë në gjendje të kryejnë funksionet e besuara Drejtoratit."³ Mandati i saj ishte nisur kryesisht me sigurimin e zgjidhjeve efikase të kërkesave të pronave banesore që kanë dalur nga shkeljet e të drejtave të pronës që kanë ndodhur gjatë dekadës paraprirëse së bashku me pronën e menaxhuar të vendosur nën administrimin e saj të përkohshëm.

³ Neni 1.1 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

Përkitazi me zgjidhjen e kërkesave pronësore, HPD-së i ishte besuar përgjegjësia për mbledhjen, përpunimin dhe përcjelljen e kërkesave për shqyrtim tek komponenta e saj e pavarur kuasi gjyqësore, Komisioni i Kërkesave Pronësore dhe Banesore (HPCC). Neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 përcaktoi tri kategori të veçanta të kërkesave për të cilat HPD-ja ishte kompetente për t'i mbledhur dhe përpunuar, si vijon:

- “(a) Kërkesat nga personat fizik, pronësia, posedimi apo të drejtat banesore të të cilëve mbi pasurinë e paluajtshme banesore u janë revokuar pas 23 marsit 1989 në bazë të legjislacionit i cili është diskriminues në aplikimin dhe apo synimin e tij.”*
- (b) Kërkesat nga personat fizik të cilët kanë hyrë në transaksion jo zyrtar të pronës së paluajtshme banesore në bazë të vullnetit të lirë të palëve pas 23 marsit 1989;*
- (c) Kërkesat nga personat fizik të cilët ishin pronarë, posedues apo bartës të së drejtës së banimit të pronave të paluajtshme banesore para 24 marsit 1999 dhe të cilët tani nuk gëzojnë posedimin e pronës, dhe ku prona nuk është bartur në mënyrë vullnetare.”*

Kërkesat u emëruan në pajtim me dispozitat e Rregullores si kërkesa të kategorisë A, B dhe C. Kërkesat e kategorisë A adresuan humbjet diskriminuese të së drejtës së banimit mbi banesat në pronësi shoqërore që kanë ndodhur si rezultat i masave të kërkuara nga autoritetet ndërmjet 1989 dhe 1999. Gjatë kësaj periudhe kohore Shqiptarët nga Kosova duke qenë të shkarkuar nga vendet e tyre të punës në Ndërmarrjet me Pronësi Shoqërore (NSH) dhe Ndërmarrjet me Pronësi Publike (NP) gjithashtu kanë humbur të drejtat e tyre të banimit mbi pronat të cilat kanë qenë të lidhura me punësimin e tyre. Kërkesat e kategorisë B kërkuan krijimin e statusit të sigurtë për personat të cilët kanë hyrë në transaksione joformale të pronave banesore pas 23 marsit 1989 dhe nuk kanë mundur të regjistrojnë të drejtat e tyre pronësore si pasojë e legjislacionit diskriminues, përkatësisht Ligji mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Kufizimit të Transaksioneve të Pasurisë së

Patundshme.⁴ Çdo person i cili ka fituar posedim të pasurisë së pronës përmes transaksionit jozyrtar ka të drejtë në urdhër për regjistrim të së drejtës pronësore në shënimet zyrtare. Kërkesat e kategorisë C kishin për synim kthimin e posedimit të pronës atyre që kishin humbur posedimin për shkak të rrethanave diskriminuese të fushatës ajrore të NATO-s dhe nuk mund të ktheheshin, për shkak të uzurpimit ilegal të shtëpive të tyre.

Përveç funksionit të saj në përpunimin e kërkesave, HPD-së gjithashtu iu besua një numër funksionesh tjera në fushën e të drejtave pronësore banesore si në vijim:-

- (a) *Të bëjë një inventar të shtëpive të baraktisura me pronësi banesore private, shtetërore dhe shoqërore;*
- (b) *Të mbikqyrë shfrytëzimin apo qiranë e një prone të tillë të braktisur mbi baza të përkohshme për qëllime humanitare; të hollat e qirasë të pronave me pronësi private dhe shoqërore do të regjistrohen në llogari të ndara në trustin për pronarët e ligjshëm, pasi t'i jenë nënshtruar zbritjes së shpenzimeve relevante;*
- (c) *T'i ofrojë udhëzim UNMIK-ut duke përfshirë Policinë Civile dhe UNHCR si dhe KFOR-in në çështjet specifike lidhur me të drejtat pronësore; dhe*
- (d) *të bëjë hulumtime të cilat çojnë në politika dhe legjislacione rekomanduese lidhur me të drejtat pronësore.”⁵*

Zyra qendrore e HPD-së gjindej në Prishtinë ⁶ dhe kishte zyrat e përhershme regjionale në gjithë Kosovën dhe një zyre përfaqësuese në Beograd (Serbi) me degë në Podgoricë

⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë 22/91, e datës 18 prill 1991. Në vitin 1999 ekspertët e Këshillit të Evropës këtë ligj e konsideruan qartë si diskriminues dhe më 13 tetor 1999, UNMIK-u anuloi ligjin përmes nxjerrjes së Rregullores 1999/10.

⁵ Shih nenin 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

⁶ Zyra ekzekutive e HPD/KPA-së gjindej në Rr Goleshi Nr. 2. Prishtinë dhe shërbimet e dosjeve të saj, sekretariati dhe zyrat qendrore të përpunimit të lëndëve gjindej në Rr. Vllaznim Bashkimi nr. 51, Prishtinë. Prej Dhjetorit 2006 zyrat qendrore të KPA-së janë shkrirë së bashku nën një pullaz dhe gjinden në rr. Nazim Gafurri (ish Milladin Popovic) Nr. 1 Prishtinë. Lista e plotë e adresave dhe detajeve kontaktuese për zyrën qendrore dhe zyrat regjionale të HPD-së gjindet në faqen e pasme të këtij raporti, apo webfaqen e saj në www.kpaonline.org.

(Mal të Zi) dhe në një zyre të vogël ndërlidhëse në Shkup (IRJM). Gjuha e saj e punës ishte Gjuha angleze, por dokumentet zyrtare gjithashtu lëshoheshin në Shqip dhe Serbisht.

HPD-ja ndërpreu funksionimin në mars të vitit 2006 kur u përfshi në një agjenci të re statutore, në KPA, e cila u ngarkua me përgjegjësinë për të përfunduar zbatimin e mandatit të saj të pronave banesore, duke marrë menaxhimin e portofolios së pronave të saj administrative.⁷

1.2.2 Rastet e HPD-së

HPD-ja filloi pranimin e kërkesave në Kosovë në fund të vitit 2000 derisa pranimi i kërkesave në Serbi, IRJM dhe Mali të Zi filloi në vitin 2002. Në mbyllje të pranimit të kërkesave më 1 korrik 2003 HPD-ja kishte pranuar 29,160 kërkesa. Rreth 93% ishin kërkesa të kategorisë C, derisa vetëm pak mbi 4% dhe 2% përbëheshin nga kërkesat e kategorisë A gjegjësisht B.

Tabela më poshtë ilustron ndarjen gjeografike dhe numrin e kërkesave të pranuar.

Regjioni/ Kategoria	Gjilan	Mitrovicë	Peja	Prishtinë	Prizren	Totali	% totale e kërkesave
A	112	203	97	698	102	1.212	4.2
B	45	65	57	579	20	767	2.6
C	3.617	3.542	7.975	8.293	3.755	27.182	93.2
Totali	3.774	3.810	8.129	9.570	3.877	29.160	100
% e totalit të kërkesave	12.9	13	27.9	32.9	13.3	100	

Pronat e kërkuara

⁷ Historiati e këtij zhvillimi përshkruhet në paragrafin 1.4.2 të këtij raporti.

Shqyrtimi dhe zbatimi i këtyre kërkesave shqyrtohet më tutje në këtë raport.⁸

1.3 Komisioni i Kërkesave Pronësore dhe Banesore (HPCC)

1.3.1 Jurisdiksioni dhe përbërja

HPCC-ja është një organ i pavarur i cili u themelua sipas nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23. U ngarkua me jurisdiksion të veçantë për të shqyrtuar dhe zgjidhur kërkesat që i drejtohen asaj nga HPD-ja, derisa *“PSSP-ja të përcaktojë që gjykatat vendore mund të kryejnë mandatin që iu besua Komisionit”*⁹

Përbëhet nga kolegji prej dy Komisionerëve ndërkombëtarë dhe një Komisioneri vendor të cilët janë emëruar nga PSSP në vitin 2000.³ PSSP gjithashtu emëroi një nga anëtarët e kolegjit si kryesues. Anëtarët të gjithë janë juristë të shquar dhe kanë sjellur në HPCC një mori të gjërë të përvojës në shumë fusha, duke përfshirë gjyqësinë, sferën akademike, praktikën private ligjore dhe ligjin e të drejtave ndërkombëtare.⁴ Emërimet e tyre sipas Rregulloren e UNMIK-ut 1999/23 ishin për një periudhë një vjeçare⁵ por që të tre anëtarët janë riemëruar në baza vjetore dhe vazhdojnë të jenë anëtarë të HPCC-së deri në fund të vitit 2006.

Prania e një përzierjeje prej dy ndërkombëtarësh dhe një Komisioneri vendor në kolegji ishte me rëndësi në shumë aspekte. Së pari, prezenca e shumicës së anëtarëve ndërkombëtarë garantoj vendim objektiv dhe të paanshëm në pajtim me standardet ndërkombëtare. Garancionet e tilla u dëshmuuan si thelbësore, në sigurimin e përkrahjes dhe besimit të komunitetit minoritar në proces. Më tej, fakti që Komisioneri vendor ishte punësuar nga popullata shumicë i dha procesit zotërim vendor dhe pranueshmëri, duke i bërë vendimet të qëndrueshme, sidomos kur bëhej fjalë për zbatimin e tyre. Ajo gjithashtu siguroi që vendimmarrja të ishte në përputhje me ligjet relevante vendore në

⁸ Shih kapitujt 2 dhe 3 të këtij raporti.

⁹ Shih nenin 2.5 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

³ Shih nenin 2.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

⁴ Një përshkrimi i shkurt mbi secilin anëtar përfshihet në shtojcën e këtij raporti

⁵ Shih nenin 17.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

fuqi. Kjo qasje megjithatë tërhoqi disa kritika nga përfaqësuesit e komuniteteve tjera etnike të cilët pohuan se mos emërimi i një anëtarit nga komuniteti minoritar rezultoi që procesi të mos jetë gjithëpërfshirës sa duhet. Gjithashtu ngriti disa kritika dhe spekulime mbi vendimet e HPCC-së që kishin refuzuar kërkesat e minoritarëve.⁶

Selia e HPCC-së ishte në Prishtinë por ajo kishte të drejtën e mbajtjes së seancave diku tjetër apo t'i mbante shqyrtimet përmes mjeteve elektronike në rastet kur kjo ishte e përshtatshme.⁷ Ajo takohet zakonisht gjashtë (6) herë në vit dhe në vitin 2006 i ka kryer 34 prej 40 seancave, gjithsej shtatë seanca. Ndihehet në kryerjen e funksioneve të veta gjyqësore nga Sekretaria. Gjuhët zyrtare të HPCC-së janë shqipja, anglishtja dhe serbishtja, por gjuha e saj e punës ishte anglishtja me përkthimin e ofruar aty ku kishte nevojë.⁸

Në mars të vitit 2006 pavarësisht nga transformimi i HPD-së në KPA-në e posa themeluar, autoriteti i HPCC-së për shqyrtimin e kërkesave të pazgjidhura ishte ruajtur.¹⁶ Ndryshimi kryesor për HPCC-në ishte se funksionet e sekretariatit dhe shërbimet e mëhershme të ofruara nga HPD-ja, u bënë përgjegjësi e KPA-së.⁹

1.4 AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS

1.4.1 Historiati dhe themelimi

Siç u nënvizua më herët, procesi i HPD/HPCC-së ishte mandatuar posaçërisht për shqyrtimin e çështjeve pronësore banesore. Derisa trajtimi sa më herët që ishte e mundur i çështjeve në sektorin e pronës banesore nga pasojat e konfliktit, në vetvete ishte elementi kyç në ndërtimin e paqes, nuk janë marrë iniciativa të krahasueshme për të

⁶ Lidhur me kërkesat e kategorisë C.

⁷ Shih nenin 17.8 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Të gjitha seancat e drejtëpërdrejta janë kryer në Zyret Qendrore të HPD-së në Prishtinë.

⁸ Shih nenin 17.15 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, dhe shkresën që Kryesuesi mund të lejojë çdo anëtar apo person që paraqitet para saj që të flasë në ndonjë gjuhë tjetër.

¹⁶ Shih nenin 23 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/10, të ndryshuar përmes nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

⁹ Neni 19 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/10, e ndryshuar me nenin 17 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

adresuar sfida tjera urgjente mbi të drejtat pronësore, siç ishin kontestet mbi tokën bujqësore dhe komerciale. Si pasojë e kësaj, si dhe për shkak të faktit që efikasiteti dhe kapaciteti i gjykatave vendore ishte projektuar gabimisht, kontestet mbi pronën bujqësore dhe komerciale mbetën të pazgjidhura për shtatë vite më vonë.¹⁰ Kjo kishte implikime për procesin e kthimit. Shumë refugjatë dhe njerëz të zhvendosur përbrenda duket se nuk kanë marrë riposedimin e shtëpive të tyre për faktin se burimi i tyre gjenerues i të ardhurave, që do të thotë objektet e tyre komerciale dhe bujqësore mbetën të uzurpura në mënyrë të paligjshme.

Raporti i vitit 2005 i të dërguarit Special të KB mbi Standardet (përndryshe i njohur si “Raporti i Kai Eides”) identifikoi uzurpimin e paligjshëm të pronës bujqësore dhe komerciale si njëri nga faktorët më të rëndësishëm që pengoi kthimin në Kosovë, dhe kështu kërkoi intervenim urgjent. UNMIK-u iu përgjegj konstatimeve të Raportit të marsit 2006 duke nxjerrur Rregulloren 2006/10 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluejtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale. Rregullorja themeloi agjencinë e pavarur, e njohur si Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) për të zgjidhur kërkesat e pronës së paluejtshme që kanë dalur nga konflikti i armatosur i vitit 1999, përfshirë kontestet mbi pronën bujqësore dhe komerciale.

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/10, të ndryshuar me 2006/50, KPA-ja funksionon pavarësisht nga institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) si organ i pavarur në pajtim me kapitullin e 11.2 të Kornizës Kushtetuese, nën përkrahjen e Bordit Mbikëqyrës.

1.4.2 Kalimi i funksioneve të HPD-së dhe kompetencat e vazhdueshme të HPCC-së

Sipas Rregulloreve të UNMIK-ut 2006/10, të ndryshuar nga 2006/50, KPA-ja ka mandatin që të marrë përgjegjësinë për punën e HPD-së, që do të thotë zbatimin e të gjitha kërkesave pronësore dhe banesore që nuk janë zgjidhur më 4 mars 2006, dhe menaxhimin

¹⁰ Shih Pasqyrën e OSBE-së mbi Sistemin e Drejtësisë Penale të titulluar “*Administrimi i Drejtësisë në Gjykatat Komunale*”, mars 2004 në faqen 9; si dhe raportin përfundimtar të përpiluar nga ECO që i është dërguar Agjencionit European për Rindërtim (AER) i datës 13 dhjetor 2004 faqe 13 dhe 25; si dhe raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë në Këshillin e Sigurimit të datës 26 maj (S205/335) në para. 67.

portfolios së administrimit të pronave nën administrim. Duke ushtruar këtë aspekt të mandatit, KPA-ja përfshinë “të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe fuqitë e HPD-së.”¹⁹

Më tutje pronat fizike të HPD-së janë përfshirë në KPA, dhe personeli i saj tani është i punësuar nga KPA-ja në postet e njëjta.²⁰

Sa i përket numrit të kërkesave të HPCC-së, neni 22 i Rregullores 2006/50 ka ruajtur kompetencën e HPCC-së që të bëjë shqyrtimin e kërkesave të pazgjidhura pronësore dhe banesore dhe kërkesave të parashtruara për rishqyrtim të vendimeve të HPCC-së në pajtim me nenin 14 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.²¹ Siç u nënvizua më parë, ndryshimi i vetëm ishte se shërbimet e sekretarisë HPCC-së që nga marsi i vitit 2006 e tutje i ofroreshin nga KPA-ja.

Kjo qasje në themelimin e KPA-së transformoi HPD-në në KPA në mënyrë efektive.

Kalimi i shpejtë siguron që metodologjia dhe procedurat efektive të përdorura nga HPD-ja paraprakisht në zgjidhjen e kërkesave pronësore dhe banesore të zbatohen në përpunimin e kërkesave për tokë dhe prona komerciale. Poashtu siguron që këto kërkesa të zgjidhen shpejtë dhe me sukses, si dhe në pajtim me procedurat që garantojnë paanësi dhe procedura të drejta.

1.4.3 Mandati dhe përbërja e KPA-së

¹⁹ Shih nenin 19 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/10 të ndryshuar përmes nenit 17 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

²⁰ Neni 19 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/10 parasheh “Agjencia Kosovare e Pronës do të ushtrojë fuqitë e zbatimit sa i përket çdo vendimi dhe urdhri për dëbim të komisionit për Kërkesa Pronësore e Banesore e cila pas hyrjes në fuqi të Rregullores së tanishme mund të zbatohet, por nuk është zbatuar nga Drejtorati për Çështje Pronësore e Banesore. Me ushtrimin e fuqisë së tillë të zbatimit, Agjencia Kosovare për Pronë do të ketë të drejtat, obligimet, përgjegjësitë, dhe fuqitë të cilat i kishte Drejtorati për Çështje Pronësore Banesore para hyrjes në fuqi të Rregullores së tanishme.” Neni 17 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 përmbante dispozitë të ngjashme që parashihte “Agjencia Kosovare për Pronë do të ushtroj fuqitë e zbatimit sa i përket çdo vendimi apo urdhri për dëbim të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore e cila nga data e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10 mund të ekzekutohet por nuk është zbatuar nga Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore. Me ushtrimin e kësaj fuqie ekzekutuese Agjencia Kosovare e Pronës do t’i ketë të drejtat, obligimet, përgjegjësitë dhe fuqitë e asaj se Drejtorati për Çështje Pronësore dhe Banesore kishte para hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10.”

KPA-ja është mandatuar që të zgjidh kërkesat që janë rrjedhojë e konfliktit të armatosur të vitit 1999 që kanë të bëjnë me pronat e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe komerciale përkitazi me:

- (i) Kërkesave mbi pronësinë lidhur me pronat e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe komerciale; dhe
- (ii) Kërkesave që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore që ka të bëjë me pronat e paluajtshme, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale.

KPA-ja përbëhet nga tri organe, përkatësisht nga Bordi Mbikqyrës, Sekretaria ekzekutive dhe Komisioni autonom për Kërkesa Pronësore të Kosovës (“HPCC”).

Bordi Mbikqyrës

Bordi mbikqyrës është i mandatuar që të punojë dhe ofrojë mbikqyrje administrative, orientim të përgjithshëm dhe politikat e udhëheqjes. Megjithatë ai është qartë i përjashtuar nga pjesëmarrja në proces përmes së cilës KPCC-ja shqyrton dhe merr vendime mbi kërkesat.

Bordi përbëhet nga 5 anëtarë, të emëruar nga PSSP-ja kurse dy nga anëtarët janë të emëruar nga Kryeministri i IPVQ.²² Kryetari është i përcaktuar nga PSSP-ja nga njëri prej tre anëtarëve që nuk janë emëruar nga Kryeministri. Më 29 qershor 2006 PSSP-ja emëroi pesë anëtarët e Bordit të cilët ishin z. Steven Schook, ZPSSP (anëtar dhe kryetar i Bordit), z. David Blunt dhe z. Kirk McBride²³ (nga zyra Britaneze përkatësisht ajo e SHBA-së, përfaqësuesit e komunitetit donator), z. Ardian Gjini dhe z. Milorad Todorovic (që përfaqësojnë interesin e publikut). Takimi përurues i Bordit u mbajt më 12 korrik 2006 dhe ai mbledhet çdo tre muaj. Dy takime tjera u mbajtën gjatë vjeshtës së vitit 2006. Mbledhja më e afërt e nëntorit shërbeu si platformë për të ngritur vetëdijësimin mbi KPA-

²¹ Neni 22 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 përmbante dispozitën e ngjashme.

²² Shin nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

²³ Z. McBride përfundoi postin e tij në Kosovë në shtator të vitit 2006 dhe u zëvendësua nga z. Thomas K. Yazdgerdi i zyrës Amerikane në Prishtinë

në dhe për të kërkuar mbështetje nga subjektet tjera në këtë proces, bashkëpunimi dhe mbështetja e të cilëve është shumë e rëndësishme për zbatimin e suksesshëm të mandatit të KPA-së. Në takim morën pjesë të gjithë donatorët në Kosovë dhe grupet tjera përkatëse të interesuara, përfshirë agjencitë për zbatimin e ligjit- gjithsej 26 pjesëmarrës.

Sekretaria ekzekutive

Sekretaria ekzekutive është përgjegjëse për pranimin dhe regjistrimin e kërkesave dhe përgjigjeve ndaj kërkesave, njoftimin e palëve dhe përpunimin e kërkesave për t'u shqyrtuar nga Komisioni. Detyrat e saj së bashku me rregullat e procedurës do të përcaktohen në urdhëresën administrative që do të nxirret në fillim të vitit 2007, e cila do të përmbaj dispozita të ngjashme si ato që kanë udhëhequr procesin e HPD-së të përcaktuar në rregulloren e UNMIK-ut 2000/60.

Sekretaria ekzekutive e KPA-së do të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme në përpunimin e kërkesave, në referimin dhe prezantimin e tyre Komisionit. Do të funksionojë në bazë të ngjashme me atë të HPD-së duke ofruar funksionet e sekretarisë KPCC-së. Kjo përfshinë njoftimin e banorëve aktual dhe palëve të interesuara mbi kërkesat, verifikimin e dokumenteve, mbledhjen e dëshmive dhe mbajtjen e bisedave me palët në kërkesë. Tani e tutje do të përgatis parashtresat mbi kërkesat me shkrim dhe do t'ia prezantojë ato Komisionit për shqyrtim.

Procesi i KPA-së është kryesisht administrativ, por procedurat e saj përmbajnë disa elemente kundërthënëse dhe gjyqësore. Procedurat e saj pasqyrojnë koncepte dhe parime të zakonshme të procedurave të drejta dhe procedurave përpunuese duke marrë parasysh edhe standardet ndërkombëtare të pranura në përgjithësi.

Pas përfundimit të procesit të vendimmarrjes para Komisionit në shkallën e parë,²⁴ mund t'i bëhet ankesë Gjykatës Supreme të Kosovës e cila do të bëjë dëgjimin e ankesave në

²⁴ Në pajtim të Rregullores së UNMIK-ut 2006/10, është paraparë që vendimi i KKKP-së, i njohur si "përfundimet" t'i referohet gjykatës kompetente për konfirmim apo refuzim. Megjithatë, për shkak të kapacitetit të gjykatave të cilat nuk i kanë plotësuar planet e shpallura paraprakisht, dhe në mënyrë që të

kolegjet e posaçme prej tre anëtarësh, dy prej të cilëve do të jenë ndërkombëtarë dhe njëri do të jetë i vendit.²⁵

Kapitulli i V i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i jep mandatin KPA-së për zbatimin e suksesshëm të vendimeve përfundimtare mbi kërkesat. Kjo do të arrihet nëpërmjet mjeteve ligjore siç janë vënia e pronës nën administrimin e KPA-së, riposedimi, ndërprerja e objekteve të paligjshme, ankandi, kompensimi dhe marrëveshjet mbi qiranë, dhe të gjitha këto do të ndihmojnë dhe do të sigurojnë kthimin e pronave bartësve të ligjshëm të së drejtës pronësore.

Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës (HPCC)

HPCC-së i është dhënë jurisdiksioni për shqyrtimin e kërkesave të referuara nga Sekretaria ekzekutive. Ai përbëhet nga dy anëtarë ndërkombëtarë dhe një anëtar vendor të cilët do të emërohen nga PSSP-ja në fillim të vitit 2007, dhe njëri nga anëtarët ndërkombëtarë do të caktohet si kryetar. Anëtari vendor do të emërohet pas emërimit të kryetarit të gjykatës Supreme të Kosovës.

1.4.4 Pranimi i kërkesave

Në pajtim me rregulloren e UNMIK-ut 2006/10, të përmirësuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50, KPA-ja ka mandat të posaçëm për pranimin e kërkesave që hyjnë nën jurisdiksionin e saj. Lëndët që hyjnë në jurisdiksionin e KPA-së dhe që nuk kanë filluar pranë gjykatave në datën e shpalljes së Rregullores poashtu duhet t'i dorëzohen KPA-së për shqyrtim.

Procedura e KPA-së kërkon që kërkesat të parashtrohen personalisht nga paraqitësit e kërkesave, apo përmes anëtarëve të ngushtë të familjes apo përfaqësuesve të autorizuar

siguroj zgjidhje të shpejtë të kërkesave, Rregullorja e UNMIK-ut pezulloi zbatimin e Rregullores 2006/10 dhe parasheh që vendimet e KKPK-së janë përfundimtare dhe të detyrueshme, përveç nëse bëhet ankesë në gjykatën Supreme të Kosovës.

²⁵ Shih nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

duke vizituar cilëndo nga zyrat e KPA-së apo njërive lëvizëse dhe duke plotësuar formularin e kërkesës me ndihmën e zyrtarit të KPA-së. Procedura filloi me pranimin e kërkesave në Kosovë më 5 prill 2006 në 5 zyrat regjionale të saj që gjinden në Gjilan, Mitrovicë, (me nënzyrat në pjesët veriore dhe jugore të qytetit), Pejë, Prishtinë (përfshirë edhe nën-zyrën në Graçanicë) dhe Prizren. Pranimi i kërkesave në Serbi filloi në korrik të vitit 2006 në zyrën e saj në Beograd dhe që nga gushti i vitit 2006 në zyrat e Kragujevcit dhe Nishit.²⁶ Pranimi i kërkesave në IRJM (zyra në Shkup) dhe Mal të Zi (zyra në Podgoricë) filloi në shtator 2006. Ende nuk është caktuar ndonjë afat kohor për ndërprerjen e pranimin të kërkesave.

Më 31 dhjetor të vitit 2006 janë pranuar rreth 7,761 kërkesa. Rreth 6,781 (87,4%) e tyre kanë të bëjnë me toka, derisa 484 (6.2%) kanë të bëjnë me pronat komerciale dhe 496 (6.4%) kanë të bëjnë me prona banesore. Në pothuajse 99% të kërkesave të parashtruara paraqitësit e kërkesave kërkojnë të drejtat e pronësisë mbi pronën e kërkuar.

Dy tabelat e mëposhtme ilustrojnë numrin, natyrën dhe ndarjen regjionale të kërkesave të parashtruara

Lloji i të drejtave pronësore të kërkuara nga paraqitësit e kërkesave deri më 31 dhjetor 2006

Regjioni/kategoria	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prishtinë	Prizren	Gjithsej	% e kërkesave
Pronësia	1,202	921	2,636	1,728	11,83	7,670	98.8
Të drejtat pronësore	9	20	17	27	18	91	1.2
Gjithësej	1,211	941	2,653	1,755	1,201	7,761	100
% e kërkesave	15.6	12.1	34.2	22.6	15.5	100	

²⁶ Nga zyrat e Kragujevcit dhe Nishit do të shpërndahen ekipet lëvizëse në zonat tjera ku banon popullata e zhvendosur nga Kosova.

Lloji i pronës së kërkuar

Regjioni/ Lloji i Pronës	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prishtinë	Prizren	Gjithsej	% kërkesave
Banesore	72	51	164	127	82	496	6.4
Komerciale	55	112	110	151	56	484	6.2
Tokë bujqësore	1,084	778	2,379	1,477	1,063	6,781	87.4
Gjithsej	1,211	941	2,653	1,755	1,201	7,761	100
% e Kërkesave	15.6	12.1	34.2	22.6	15.5	100	

KAPITULLI 2

PËRPUNIMI DHE SHQYRTIMI I KËRKESAVE PRONËSORE DHE BANESORE TË PARAQITURA NË HPD

2.1 Praktika dhe procedura

Roli i HPD-së në procesin e zgjidhjes së kërkesave ishte t'i ofrojë HPCC-së shërbime të sekretarisë. HPD-ja ishte përgjegjëse për pranimin, regjistrimin, përpunimin dhe referimin e kërkesave HPCC-së, për shqyrtim. Kjo përfshinte hetimin e kërkesave, njoftimin e palëve, verifikimin e dokumenteve dhe përpunimin e parashtresave ligjore dhe rekomandimet mbi të gjitha kërkesat. HPD-ja nuk kishte kompetencë të vendimmarrjes së pavarur dhe nuk mund të shqyrtonte kërkesat.²⁷ Megjithatë mund të

²⁷ Neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, i imponoi obligimin statutar HPD-së, që të gjitha kërkesat që nuk mund të ndërmjetësoheshin t'i referoj HPCC-së për shqyrtim. Roli i dhënë ndërmjetësues i HPD-së sipas nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut

refuzonte kërkesat që ishin jashtë jurisdiksionit të HPCC-së dhe të lëshonte urdhra në lidhje me kërkesat e pakontestueshme për të regjistruar të drejtat pronësore mbi pronat në të regjistrin publik të pronave.²⁸ Duhet të theksohet se obligimet dhe përgjegjësitë e ngjashme vlejnë edhe për KPA-në që nga marsi 2006 e tutje kur mori përgjegjësinë për veprimet e HPD-së.

Për kryerjen efektive të pranimit, përpunimit dhe shqyrtimit të kërkesave, janë miratuar procedura të detajuara përmes shpalljes së pastajme nga Rregullorja e UNMIK-ut në fund të vitit 2000, respektivisht Rregullorja 2000/60 mbi Rregullat e Procedurës dhe Dëshmive të HPD/HPCC-së. Kjo Rregullore e cila u hartua në bazë të ideve dhe marrëveshjes së përgjithshme të grupeve të interesuara përfaqësoi një hap të madh për të drejtat pronësore në Kosovë. Kapitulli II përcaktoi praktikën e cila udhëhoqi përpunimin e kërkesave dhe referimin e tyre te HPCC-ja për shqyrtim. Kapitulli III përcaktoi rregullat e procedurës së HPCC-së në lidhje me dëshmitë, seancat dëgjimore dhe vendimmarrjen.²⁹ Rregullorja përfshiu konceptet kyçe të përpunimit dhe parimet e ngjashme të saj siç janë drejtësia e procedurave. Kjo është në pajtim me kriteret e nenit 2.6 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 e cila qartë kërkon që rregullat e HPCC-së mbi dëshmitë dhe procedurën të garantojnë veprime të drejta dhe të paanshme në pajtim me standardet e të drejtave njerëzore të pranuar ndërkombëtarisht.

1999/23 nuk u shfrytëzua ngase palët e kërkesave kontestuese ose zgjodhën që kërkesat e tyre ose të vendosen nga HPCC-ja ose thjeshtë i tërhoqën kërkesat e tyre.

²⁸ Neni 11.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 lejoi HPD-në që të lëshoj urdhra për regjistrimin e të drejtës pronësore në rastet e pakontestueshme të kategorisë B. Neni 10.3 i Rregullores përcaktoi jurisdikcionin që të refuzoj kërkesat, por të vihet re se në rastet kur paraqitësi i kërkesës kontestoi refuzimin e HPD-së, kërkesa duhet t'i referohej HPCC-së për shqyrtim.

²⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 më 31 tetor 2000.

Vendimet e HPCC-së janë të detyrueshme dhe të zbatueshme dhe nuk mund të rishqyrtohen nga asnjë autoritet tjetër administrativ në Kosovë³⁰ që i nënshtrohet vetëm nenit 14 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 e cila parasheh procedurën e rishqyrtimit, të njohur si “rishqyrtim” i vendimeve që mund të kërkohen nga palët në kërkesë apo palët e treta të interesuara.

HPCC-ja mund t’ia referoj çështjet e veçanta që rrjedhin përkitazi me kërkesën, të cilat nuk janë në jurisdiksionin e saj, gjykatës vendore apo organit administrativ apo tribunalit.³¹

Në seancën e tetorit 2006 HPCC-ja përfundoi shqyrtimin e të gjitha 29,160 kërkesave të shkallës së parë. Vendimet e detyrueshme janë lëshuar për të gjitha kërkesat dhe u janë dorëzuar palëve në kërkesë. Diku 68% e kërkesave ishin vendosur brenda 3 viteve pas paraqitjes së tyre.

2.1.1 Procedurat e rishqyrtimit

Në rastet kur kërkesa është vendosur nga HPCC-ja, neni 14 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 ia ofronte palës në kërkesë dhe secilit person të interesuar mundësinë që të kërkoj rishqyrtimin e vendimit. Një kërkesë e tillë duhet të parashtrohet brenda (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit por jo më vonë se një (1) vit nga data e vendimit. Kërkesat duhet të bazohen në bazë të asaj se dëshmitë e rëndësisë ligjore nuk janë shqyrtuar nga HPCC-ja në vendmimirrjen fillestare, apo në bazë të asaj se kishte gabim material në zbatimin e dispozitave të rregullores gjatë zgjidhjes së kërkesës.

Deri në dhjetor të vitit 2006 janë parashtruar rreth 4,253 kërkesa për rishqyrtim të vendimeve të HPCC-së, duke përfaqësuar 14.6 % të vendimeve të marra. Deri në fund të vitit 2006, HPCC-ja kishte shqyrtuar gjithsej 3,918 kërkesa (rreth 2,441 u vendosën gjatë 2006) kurse 335 kërkesat tjera të mbetura do të vendosen në seancat e HPCC-së në vitin 2007. Gjatë vitit 2006 HPCC-ja aprovoi 14% të kërkesave dhe 86% e tyre u

³⁰ Shih nenin 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23.

³¹ Shih nenin 22.1 të Rregullores 2000/60. HPCC-ja i referoi kërkesat gjykatës në pajtim me nenin 22.1 në përfaqësisht 925 raste.

refuzuan. Në shumicën e rasteve pala kërkuese nuk prezantoi dëshmi të rëndësishë ligjore të cilat nuk ishin shqyrtuar paraprakisht nga HPCC-ja gjatë vendimmarrjes dhe nuk kishin sjellur dëshmi mbi gabim material në zbatimin e rregullores. Shumica e kërkesave për rishqyrtim ishin të bazuara mbi rrethanat personale të palëve kërkuese, apo në baza tjera të cilat u konsideruan si të parëndësishme në përcaktimin e kontestit pronësor, si në baza humanitare ku pala kërkuese deklarohet se ai apo ajo nuk kishte vend tjetër strehimi. Numri i kufizuar i kërkesave dhe kundërshtimeve të mirëfillta ndaj vendimeve të HPCC-së dëshmon mbi nivelin e lartë të kënaqshmërisë dhe pranimit të vendimeve. Kjo nuk do të ndodhte po qe se palët do të kishin arsye të dyshonin në bazën ligjore të vendimit apo drejtësinë e procedurave në lidhje me vet procesin e vendimmarrjes.

Vendimet e HPCC-së në vitin 2006

Seanca e Komisionit	Numri i kërkesave për rishqyrtim	Numri i vendimeve në shkallën e parë
E 34-të	423	75
E 35- të	155	66
E 36-të	677	16
E 37-të	364	18
E 38-të	358	4
E 39-të	311	0
E 40-të	153	0
<i>Gjithësej</i>	<i>2, 441</i>	<i>179</i>

KAPITULLI 3

ZBATIMI I VENDIMEVE TË HPCC-së

3.1 Hyrje

Gjatë aprovimit të kërkesës HPCC-ja mund të urdhronte regjistrimin e të drejtës pronësore në regjistrin publik të pronave, apo kompensimin ose riposedimin varësisht nga kategoria e kërkesës dhe çështjet e ngritura ligjore. Përpiluesit e procesit të HPD/HPCC-së ishin mjaft të vetdijshëm se vendimi në vetvete ishte i pamjaftueshëm në shoqërinë e pas luftës për t'ia kthyer posedimin e pronës paraqitësit të kërkesës apo për ta siguruar regjistrimin e të drejtave pronësore apo pagesën për kompensim. Kështu që, në mënyrë që të sigurojë zbatimin e vendimeve të HPD-së dhe tani KPA-së e cila mori përgjegjësinë për zbatimin e vendimeve mbi kërkesat e pronave banesore nga marsi i vitit 2006,³² i

³² Shqyrtuar në pragrafin 1.4.2 të këtij raporti

është dhënë fuqia që të sigurojë pajtueshmëri me vendimet e detyrueshme ligjore të HPCC-së. Ajo mund të zbatonte vendimet duke lëshuar urdhra për dëbim në raste kur banimi i pa ligjshëm i pronës pengonte që paraqitësit të kërkesës t'i kthehet posedimi i pronës. Ajo ka mandatin që të themeloj Fondin e Mirëbesimit për t'ia paguar kompensimin paraqitësve të kërkesave, të caktuar nga HPCC-ja dhe të lidhë çfarëdo marrëveshje të nevojshme për zbatim të suksesshëm të vendimit të HPCC-së.

Paraqitësve të kërkesave të cilët kanë marrë vendimin e HPCC-së ku u njihet e drejta e tyre pronësore ky process u prezanton një sër zgjidhjesh për zbatimin e vendimeve të tyre, e cila përfshinte riposedimin e menjëhershëm të pronës apo vënien e saj nën administrimin e përkohshëm të KPA-së.

Këtu procesi i zbatimit është shikuar nga aspekti se si ai ndihmoi kthimin e pronave bartësve të së drejtës së ligjshme pronësore apo se si u mundua që të mbrojnë të drejtat pronësore në rastet ku kthimi në lloj nuk ishte më i mundur apo i zbatueshëm.

3.2 Regjistrimi i të drejtave pronësore

Paraqitësit e suksesshëm të kërkesave të cilët morën vendimet ku urdhrohet regjistrimi i pronësisë së pronave të tyre në regjistrat përkatës publik janë ndihmuar në regjistrimin e të drejtave të tyre pronësore.³³ Në këtë aspekt, HPD-ja arriti një mirëkuptim të përbashkët me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) e cila është përgjegjëse për regjistrimin e pronësis në regjistrat publik të pronave. Agjencia Kadastrale e Kosovës ndër morri regjistrimin e të gjitha vendimeve të HPCC-së pas marrjes së kopjes së vërtetuar të urdhrit të HPD/HPCC-së, së bashku me kërkesën me shkrim për regjistrim si nga HPD-ja ashtu edhe nga paraqitësit të kërkesës. Para marsit të vitit 2006 kur KPA-ja morri përgjegjësinë për zbatimin e vendimeve të pazgjidhura, HPD-ja u lëshoi të gjithë paraqitësve të kërkesave urdhrin e HPD/HPCC-së në lëndën e tyre dhe ata poashtu ishin të njoftuar mbi kërkesën për të parashtruar AKK një kërkesë me shkrim.

³³ Kjo çështje hynte në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) sipas nenit 3.7 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/22. Një marrëveshje e përbashkët u arrit ndërmjet AKK dhe HPD-së në maj të vitit 2005.

3.3 Marrja e riposedimit apo vënia e pronës nën administrim

Në rastet kur HPCC-ja urdhronte kthimin në lloj, paraqitësit e kërkesave kishin të drejtë të zgjedhin tri opsione të mundshme për zbatimin e vendimit të HPCC-së. Ata mund të kërkonin riposedimin e menjëhershëm të pronave të tyre. Përndryshe, duke njohur faktin se jo të gjithë paraqitësit e kërkesës kërkonin të ktheheshin në pronat e tyre në kohën kur morën vendimet e tyre, paraqitësit e kërkesave mund të zgjedhnin që pronën e tyre ta vinin nën administrimin e përkohshëm të HPD-së.³⁴ Opsioni i tretë ishte mbyllja e dosjes së kërkesës e cila kryesisht zgjedhej nga paraqitësit e kërkesave të cilët vet e kishin gjetur zgjidhjen dhe nuk kishin më nevojë për ndihmën e HPD/KPA-së në lidhje me pronat e tyre, p.sh. në rastet kur paraqitësit e kërkesave e kanë shitur pronën apo vullnetarisht kanë hequr dorë nga ajo.³⁵

Në rastet kur është kërkuar riposedimi, HPD/KPA organizonte dorëzimin e çelësave paraqitësit të kërkesës.

Pas dorëzimit të kërkesës për riposedim apo administrim të parashtruar nga paraqitësi i kërkesës, zyrtarët e zyrave regjionale të HPD-së apo KPA-së vizitonin pronën në mënyrë që të vlerësonin gjendjen e saj fizike, meqenëse pronat e pabanueshme dhe të shkatërruara nuk mund të vireshin nën administrim dhe riposedimi në këto raste nuk ishte zgjedhje për paraqitësit e kërkesave.

Në rastet kur paraqitësit e kërkesave kërkonin administrimin dhe prona ishte e banueshme dhe nuk ishte e uzurpuar, prona është plumbuar dhe zyrtarisht është vënë nën administrim.

³⁴ Neni 1.1 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 lejoi HPD-n që të shfrytëzoj pronën nën administrimin e saj në baza të përkohshme humanitare. Sa i përket administrimit në përgjithësi, shih kapitullin 4 të këtij raporti vjetor.

³⁵ Me pranimin e kërkesës për mbylljen Kryesekretari hartoi një shkresë e cila theksonte se paraqitësi i kërkesës kërkonte mbylljen, dhe të dyja edhe shkresa edhe kërkesa u dërguan me dosje në arkivim.

Në rastet kur është zbuluar se një pronë është uzurpuar në mënyrë të paligjshme, banorit i është dhënë një kopje e vendimit të HPCC-së, duke e urdhruar që ta liroj pronën brenda tridhjetë (30) ditësh dhe nëse nuk i përmbahet kësaj ai apo ajo do të dëbohej.³⁶ Në mënyrë që të sigurohet drejtësia e procedurave, në këto raste banori mund të kërkonte strehim humanitar, apo të parashtronte kërkesë për rishqyrtim të vendimit. Zbatimi i urdhrit për dëbim të pazgjidhur është ndërprerë automatikisht në kohën kur parashtrohet kërkesa për rishqyrtim në HPD/KPA deri sa HPCC-ja të vendos mbi kërkesën, përveç nëse HPCC-ja nuk kishte vendosur të kundërtën.³⁷ Kërkesat për strehim humanitar duhej të parashtroheshin brenda 14 ditësh nga pranimi i vendimit.³⁸ Në rastet kur paraqitësi i kërkesës ka kërkuar administrimin dhe HPD/KPA ka konstatuar se kërkesa e paraqitësit të kërkesës ishte e bazuar,³⁹ atëherë duke e vendosur pronën në administrim mund t'ia aprovonte banorit lejen e përkohshme që të banonte aty në pajtim me nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Në rastet kur paraqitësi i kërkesës kërkonte riposedimin, ofrimi i strehimit humanitar për banorin varej nga mundësia e posedimit të pronave tjera të përshtatshme dhe kriteret që duheshin plotësuar. HPD/KPA-ja sipas jurisprudencës së vet, mund ta shtyente zbatimin e urdhrit të dëbimit deri në 6 muaj, duke lënë pezull zgjidhjen e nevojave banesore të banorit, apo në raste të tilla ashtu si dukej e përshtatshme.⁴⁰ Në raste të tilla HPD/KPA mori të gjitha masat e nevojshme duke u përpjekur të gjente mundësi tjera të strehimit humanitar për të gjitha kërkesat e merituarat për strehim.

3.4 Zbatimi i urdhrave për dëbim

Në rastet kur banori nuk e lironte pronën duke mos kërkuar strehim humanitar apo rishqyrtim të vendimit të HPCC-së, është imponuar urdhri për dëbim duke lëshuar

³⁶ Shih nenin 13.2 të Rregullors së UNMIK-ut 2000/60. Në rastet kur banori u mundua që të kundërshtoj vendimin, shërbyesi I procesit e shenoi këtë fakt në fletëpranimin të cilën ai apo ajo e nënshkroi dhe ia bashkangjiti shkresave të lëndës.

³⁷ Shih nenin 14.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Në jurisprudencën e saj HPCC-ja nuk ka vendosur ndryshe deri në vitin 2006

³⁸ Periudha prej (14) ditësh mundësoi përpunimin e kërkesës para përfundimit të afatit të skadimit prej tridhjetë (30) ditësh.

³⁹ Kjo ishte në përputhje me kriteret e brendshme për të aprovuar ndihmën banesore.

⁴⁰ Shih nenin 13.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

urdhrit që autorizon zbatimin e tij.⁴¹ Dëbimet janë kryer nga zyrtarët e HPD/KPA-së me përkrahjen e autoriteteve për zbatim të ligjit.⁴²

Urdhri për dëbim ishte i zbatueshëm ndaj çdo pale që banonte në pronë gjatë kohës së dëbimit.⁴³ Zyrtarët e përgjegjshëm të HPD/KPA-së kërkoheshin që të posedonin urdhrin për dëbim që i autorizonte zbatimin e urdhrin për dëbim. Në pajtim me nenin 13.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, gjatë zbatimit të urdhrin për dëbim, çdo palë që nuk i përmbahej udhëzimit të lëshuar nga zyrtari përgjegjës që i kërkonte atij apo asaj të lirojë lokalet mund të largohet nga autoritetet e zbatimit të ligjit.⁴⁴ Pas dëbimit, zyrtarët e HPD/KPA-së plumbonin pronën⁴⁵ duke u përgatitur që prona të vihej nën administrim apo të sigurohet riposedimi në pajtim me kërkesën e paraqitësit të kërkesës për zbatimin e vendimit.

Në rastet kur paraqitësi i kërkesës kërkonte riposedimin, HPD/KPA-ja organizonte dorëzimin e çelësve paraqitësit të kërkesës.⁴⁶ Për shkak të burimeve të kufizuara, HPD/KPA ka të drejtë në vetëm një dëbim të paraqitësit të kërkesës. Në rastin kur paraqitësit e kërkesës organizonin pranimin e çelësve duke marrë riposedimin e pronës së kërkuar, jurisdiksioni mbi pronën automatikisht i rikthehet autoriteteve lokale. Në rastet kur pastaj shfaqet nevoja për shërbimet e zbatimit, kjo iu kthehet autoriteteve vendore, sidomos policisë që sipas statutit ishte e autorizuar të zbatojë vendimet e HPCC-së në mënyrë të pavarur.⁴⁷ Megjithatë, në rastet kur dikush e uzurponte sërish pronën e kërkuar në mënyrë të paligjshme ndërmjet datës së dëbimit fillestar dhe datës së caktuar me paraqitësin e kërkesës për riposedim, HPD/KPA merrte përgjegjësinë që të siguronte dëbimet e më vonshme të banorëve të pa ligjshëm nga prona, në mënyrë që

⁴¹ U lëshua urdhri në pajtim me nenin 13.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

⁴² Shih nenin 13.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60. Fillimisht ndihma u ofrua nga zyrtarët e policisë ndërkombëtare (policies së UNMIK-ut) dhe nga prezenca e ushtarake eudhëhequr nga NATO-ja (KFOR-i), por kjo përgjegjësi gradualisht iu bartë Shërbimit Policor të Kosovës nën udhëheqjen e policies së UNMIK-ut.

⁴³ Shih nenin 13.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

⁴⁴ Shih nenin 13.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

⁴⁵ Njësitë për zbatim bëri fotografi të pronës së kërkuar, regjistroi numrin e koordinatave të saj duke përdorur teknologjinë e GPS dhe pregaditi raportin duke përcaktuar gjendjen e pronës.

⁴⁶ Neni 13.6 I Rregullores së UNMIK-ut 2000/60

⁴⁷ Shih nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 e cila parasheh që secili person i cili hyn në prone duke thyer plumbimin pa arsytim të ligjshëm do të largohet nga prona nga autoritetet për zbatim.

prona t'i kthehej bartësit të së drejtës pronësore. Procedura e njëjtë vlente edhe për dëbimet e bëra në dobi të paraqitësve të cilët fillimisht e kishin vënë pronën nën administrimin e eHPD/KPA-së duke kërkuar pastaj riposedimin e pronës.⁴⁸

3.5 Kompensimi

HPCC-ja mund t'ua aprovonte kompensimin paraqitësve të kërkesave në raste të kufizuara. Kjo ndodhte vetëm në rastet kur konstatohej se paraqitësi i kategorisë A kishte të drejtën banesore mbi banesën në pronësi shoqërore e cila ishte anuluar si rezultat i diskriminimit, dhe paraqitësi i kërkesës së kategorisë C (apo pala përgjegjëse ndaj paraqitësit të kategorisë A), kishte të drejtën pronësore mbi pronën (duke e blerë pastaj nga bartësi i së drejtës së ndarjes sipas Ligjit mbi Banimin). Në mënyrë që të shqyrtohen kërkesat konkurruese mbi pronën, neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 ka paraparë formulën për përcaktimin e të drejtave pronësore të palëve. Ajo parashihte që paraqitësit e kërkesës së kategorisë A me të drejtën banesore t'i jepej kthimi në lloj dhe t'i aprovohej pronësia mbi pronën pasi të ken paguar shumën që do të përcaktohet nga HPD-ja,⁴⁹ dhe se paraqitësi i kërkesës C apo pala përgjegjëse do të pranonte kompensimin në të holla për humbjen e së drejtës së tyre mbi pronën. Përfundimi i vetëm ndodhte në rastet kur nuk ishte e mundur të aprovohej kthimi në lloj paraqitësit të kërkesës A për shkak të shitjes së vlefshme të pronës, palës së tretë dhe në raste të tilla paraqitësit të kërkesës A iu lëshua vërtetimi me të cilin asaj apo atij i jepej e drejta për kompensim për humbjen e së drejtës banesore.

Në rastet kur paraqitësi i kërkesës A me të drejtën banesore nuk dëshironte të blente të drejtën e pronësisë si dhe të paguante shumën e caktuar nga HPD-ja, paraqitësi i kërkesës C apo pala përgjegjëse kishte të drejtë në konfirmimin e së drejtës së tij apo saj pronësore mbi pronën kurse paraqitësit të kërkesës A me të drejtën banesore i lëshohej vërtetimi duke i dhënë të drejtën e kompensimit për humbjen e së drejtës së tyre banesore.

⁴⁸ Shih nenin 12.7 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

⁴⁹ Para së gjithash kjo përfshinte paraqitësin e kërkesës A cili ishte të drejtën banesore i cili bleu të drejtën pronësore.

Në përcaktimin e shumës së kompensimit që do t'i paguhet paraqitësve të kërkesave të kategorisë C me të drejtë kompensimi në rastet kur paraqitësit të kërkesës A i aprovohej kthimi në lloj, HPD-ja ishte obliguar që sipas nenit 4 të përcaktoj formulën dhe metodën e kalkulimit për dhënje të tilla. Poashtu kërkohej që të themelohej dhe administrohej fondi i mirëbesimit në zbatimin e skemës mbi qiranë. HPD-ja, tani KPA-ja, i kushtoi vëmendje të posaçme për vendosjen e legjislacionit dhe procedurave për zbatimin e kësaj skeme mbi qiranë. Qysh në gusht të vitit 2005 HPD-ja hartoi legjislacionin e duhur për zbatimin e skemës. Aprovimi për zbatimin e skemës u arrit me shpalljen e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe komerciale në tetor të vitit 2006 e cila kërkonte të zbatohet nën rrethanat e favorshme për KPA-së. Neni 19 i Rregullores parasheh se skema do të zbatohet *“në pajtim me kriteret dhe procedurat e miratuara nga Agjencia Kosovare e Pronës për llogaritjen e shumave të përmendura në nenin 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.”* Rreth 258 kërkesa janë në pritje të zbatimit në pajtim me nenin 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

3.6 Rastet e pronave të shkatërruara

Nga fundi i vitit 2006 rreth 10,646 prona të kërkuara janë konfirmuar si të shkatërruara nga HPCC-ja. Është mirë i njohur fakti se shkatërrimi i pronës nuk duhet t'ia humb të drejtën e refugjatëve apo personave të zhvendosur që të kërkojnë kompensim në të holla për humbjen e së drejtës së tyre pronësore dhe kthimin e ngastrës tokësore në të cilën dikur gjendej shtëpia e tyre. Megjithatë, procesit të HPCC-së nuk i ishte dhënë jurisdiksioni që të merret me kërkesat për kompensim në të holla, lidhur me dëmet apo shkatërrimin e pronës. Neni 2.6 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 qartë parandalonte HPCC-në që të pranojë *“kërkesa për kompensim për dëmet e shkaktuara apo për pronën e shkatërruar”*.

Në rastet e tilla paraqitësit të kërkesës i cili dëshmoi se i plotësonte kriteret për një urdhër për riposedit gjatë kohës së shkatërrimit të pronës, iu lëshua urdhri deklarativ që

konfirmonte të drejtën pronësore që nga koha e shkatërrimit të saj. Urdhri deklarativ mund të përdorej në procedurat gjyqësore për të kontestuar çfarëdo uzurpimi të pa ligjshëm të ngastrës tokësore në të cilën ndodhej prona, apo si dëshmi mbi të drejtën pronësore në rastet kur paraqitësi i kërkesës përpigëj që të përfitonte nga ndonjë projekt i ardhshëm rindërtues apo skemë kompensimi. Megjithatë, ky kufizim i juridiksionit rezultoi që më tepër se një e treta e paraqitësve të kërkesave të cilët i kishin parashtruar kërkesat e tyre HPD-së të mos marrin kompensim në vend të kthimit të së drejtës së tyre pronësore, në rastet kur është konstatuar se prona e tyre ishte e shkatërruar. Për fat të keq nuk janë ndërmarrë projekte rindërtimi në shkallën e nevojshme për të siguruar rindërtimin e këtyre pronave.

3.7 Statistikat mbi zbatimin

Rreth 28,439 kërkesa pronësore banesore janë zbatuar me sukses (97,5%), ku rreth 5,330 kërkesa janë zbatuar gjatë vitit 2006. Vetëm 721 kërkesa janë në pritje të zbatimit (2.5%). Rreth 4,615 paraqitës të kërkesave zgjodhën riposedimin e pronës së tyre derisa 3,425 kërkuan që HPD-ja të vendoste pronën e tyre nën administrimin e saj.

KËRKESAT E ZBATUARA GJATË VITIT 2006

Zona	Gjithsej	Të gjitha kërkesat					Kërkesat - A/C				Kërkesat -B
		Të tërhequra	Refuzim nga HPD	Refuzuara nga HPCC		Kërkes për mbyllje nga paraqitësi i kërkesës	Prona të shkatërruara	Riposedim	Refuzim nga HPD	Refuzuar nga HPCC	Pronësia e aprovuar
				Jasht Juris.	Pa merita						
Në tërë Kosovën	5,330	112	0	41	468	362	987	2,250	673	437	0
% e kërkesave të parashtruara	18.3	0.4	0	0.1	1.6	1.2	3.4	7.7	2.3	1.5	0
% e kërkesave të zbatuara	19.3	0.4	0	0.1	1.7	1.3	3.6	8.2	2.5	1.6	0

Tabela e mëposhtme prezanton ndarjen mbi statusin e përgjithshëm të zbatimit të procesit në fund të vitit 2006.

TOTALI I KËRKESAVE TË ZBATUARA

31 dhjetor 2006

Zona	Gjithsej	Të gjitha kërkesat					Kërkesat - A/C				Kërkesat -B
		Të tërhequra	Refuzim nga HPD	Refuzuara nga HPCC		Kërkes për mbyllje nga paraqitësi i kërkesës	Prona të shkatërruara	Të tërhequra	Refuzim nga HPD	Refuzuara nga HPCC	Pronësia e aprovuar
				Jasht Juris.	Pa merita						
Në tërë Kosovën	28,439	2,187	57	155	2,784	2,175	10,403	4,615	3,425	2,327	311
% e kërkesave të parashtruara	97.5	7.5	0.2	0.5	9.5	7.5	35.7	15.8	11.7	8	1.1
% e kërkesave të zbatuara	100	7.7	0.2	0.5	9.8	7.6	36.6	16.2	12	8.2	1.1
MITROVICË	3,690	132	5	17	268	235	1,317	297	1,112	294	13
GJILAN	3,689	339	1	39	325	209	1,622	505	277	365	7
PEJË	8,041	264	3	15	244	295	4,453	1,057	1,275	416	19
PRISHTINË	9,207	1,246	48	81	1,744	1,091	1,705	1,757	454	813	268
PRIZREN	3,812	206	0	3	203	345	1,306	999	307	439	4

KAPITULLI 4

PRONAT NËN ADMINISTRIM DHE SKEMA MBI QIRANË

4.1 Hyrje

Rregulloret e UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60 autorizuan HPD-në që të vendosë pronën nën administrimin e saj të përkohshëm dhe të përkujdeset në mënyrë efektive për bartësit e shpronësuar të së drejtës pronësore në situata të caktuara të kufizuara. Në mars të vitit 2006 KPA-ja duke marrë përgjegjësinë për veprimet e HPD-së morri përgjegjësinë për të udhëhequr pronat që tashmë janë nën administrimin e HPD-së, si dhe për zbatimin e vazhdueshëm të skemës.⁵⁰

⁵⁰ Sa i përket historisë së marrjes së përgjegjësisë KPA-së nga HPD-ja shih paragrafin 1.4.2 të këtij raportit.

Neni 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 autorizoi administrimin e banesave të braktisura me qëllim të sigurimit të nevojave për strehim të personave të zhvendosur dhe refugjatëve. Më tutje, neni 12 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 autorizoi administrimin e pronës banesore në rrethana si në vijim:

- (i) Me aprovimin e palëve në zgjidhjen e kërkesës;
- (ii) Me kërkesë të paraqitësit të kërkesës, pas vendimit të HPCC-së i cili konfirmon të drejtën pronësore të paraqitësit;
- (iii) Pas dëbimit të banorit aktual, nëse paraqitësit nuk mund të marrin pronën në riposëdim brenda 14 ditësh nga dita e njoftimit mbi zbatimin e dëbimit;
- (iv) Në rastet kur asnjë kërkesë nuk është parashtruar për pronën dhe prona është ose e lirë ose banori aktual nuk ka kërkuar ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën; ose
- (v) Në rastet kur asnjë kërkesë nuk është parashtruar për pronën, me kërkesë të pronarit apo bartësit të së drejtës banesore të pronës.

Kur prona gjendet nën administrim, KPA është e autorizuar ta shfrytëzoj për qëllime të ofrimit për nevoja të strehimit të personave të zhvendosur dhe refugjatëve. Kandidatëve ju lëshon leje të përkohshme për strehim humanitar në pajtim me kriteret e brendshme të ndarjes duke kryer vlerësimin e nevojave të kandidatëve.

Deri më 31 dhjetor 2006, 5,257 prona ishin nën administrim. Rreth 3,412 ishin vënë nën administrim bazuar në kërkesat e paraqitësve të suksesshëm të kërkesave, derisa 1,845 ishin braktisur dhe ishin marrë *ex officio* nën administrim.

Mandati për shfrytëzimin e pronës nën administrim në baza të përkohshme për qëllime humanitare ishte konfuz për shumë vite apo ishte interpretuar si mandat për të ofruar dhe zgjidhur strehim afatgjatë humanitar për të dëmtuarit në Kosovë. Ky nuk është pozicioni, pasi lejet e lëshuara personave të autorizuar për të banuar në pronën nën administrim u ishin aprovuar vetëm përkohsisht. Më tutje, obligimet e parashikuara me ligj për të ofruar dhe trajtuar strehimin social qëndron tek Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (“IPVQ”) dhe pjesërisht tek komunat. Kjo përgjegjësi veçse ishte transferuar nga

UNMIK-u në gusht të vitit 2000 në pajtim me nenin 1.3(k) të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45.

4.2 Skema e Qirasë

Neni 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 parasheh që skema e qirasë të vendoste për pronat që janë nën administrim. Të hollat e qirasë për pronën nën administrim kërkohet të futen në llogari bankare mirëbesimi të veçantë të pronarit të ligjshëm, duke i'u nënshtruar zbritjes së shpenzimeve përkatëse. Një skemë e tillë e qirasë ishte propozuar gjatë viteve të funksionimit të HPD-së dhe propozimet e dizajnimit të një skeme të tillë janë avancuar. Megjithatë për shkak të natyrës së ndjeshme politike të kësaj çështjeje, skema është aprovuar nga PSSP-ja tek në prill të vitit 2006, si pas kalimit të HPD-së në KPA. IPVQ qartësisht është pajtuar në zbatimin e skemës së qirasë në gusht të vitit 2006.

Skema ka hyrë në funksion në tetor të vitit 2006. KPA ka bërë marrëveshje mbi qiranë me bartësin e lejes së përkohshme, banorin, duke marrë qiranë për çdo muaj. Në rast të mospagimit të qirasë KPA-ja mund ta dëbojë banorin. KPA merr vetëm një herë depozitë nga banori në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjes mbi Qiranë. Depozitimi mbulon mospagesën e mundshme të qirasë apo dëmtimin e pronës, ku banori mban përgjegjësi për një dëmtim të tillë. Pjesa e mbetur e depozitimit i kthehet banorit me përfundimin e marrëveshjes dhe pasi që prona të jetë inspektuar. Vlera e qirasë është caktuar nga KPA-ja bazuar në vlerën aktuale të pronës siç është përcaktuar nga autoritetet publike, prandaj është e pa negociueshme. Vlerësimi fizik i pronës dhe kushtet janë marrë gjithashtu parasysh në caktimin e qirasë.

Skema shërben për të ofruar mbrojtje ligjore dhe fizike për pronën e banimit që është braktisur duke siguruar burim minimal të të ardhurave për bartësit e zhvendosur të të drejtës pronësore, të cilët përndryshe mund të vendosin të shesin shtëpitë e tyre. Gjithashtu është parashikuar kujdesi për kërkesat për strehim të përkohshëm të të kthyerve spontan në mënyrë vullnetare dhe për refuzimin e kërkuësve për strehim, të detyruar nga kombet nikoqire që të kthehen në Kosovë.

Deri më sot, 1,254 bartës të së drejtës pronësore kanë zgjedhur të marrin pjesë në skemën e qirasë të KPA-së. Janë nënshkruar rreth 38 marrëveshje mbi qiranë dhe shuma e përgjithshme e mbledhur e qirasë deri në dhjetor të vitit 2006 ishte 19,981.80 euro.

KAPITULLI 5

PERSONELI DHE KAPACITETI I NDËRTESES

Në fund të vitit 2006 rreth 248 persona janë punësuar në KPA. Shumica e këtij stafi ishin veçse të punësuar në HPD dhe automatikisht janë transferuar në pozita të ngjashme në KPA në mars të vitit 2006, kur HPD-ja ishte shndërruar në KPA.⁵¹ Iniciativa e rekrutimit kishte filluar në prill të vitit 2006 me qëllim të punësimit të stafit plotësues duke ua dhënë vendorëve pozitat udhëheqëse. Më tutje, stafi plotësues gjithashtu ishte i nevojshëm për të lehtësuar implementimin e mandatit të KPA-së, veçanërisht për të mbledhur dhe notifikuar kërkesat si dhe për të punuar në dispozitat esenciale të shërbimeve të TI-së dhe fushatës publike informative.

⁵¹ Shqyrtuar në paragrafin 1.4.2 të këtij raporti.

Personeli është i shpërndarë në njëmbëdhjetë zyre, nën-zyre shtesë dhe njësitet mobile në tërë Kosovën, Serbi, Mal të Zi dhe IRJM.

Më tepër se 90% e personelit është staf vendor – komponenti ndërkombëtar kryesisht është në pozitat këshilluese për të ofruar udhëheqje të programit, mbikqyrje dhe këshillim dhe nëse nevojitet për të mbrojtur stafin vendor duke formuar mburojë kundër presionit të jashtëm. Kjo situatë është arritur përmes përpjekjeve të vazhdueshme të arritjes së kapacitetit të ndërtimit gjatë viteve të operimit të cilat në mënyrë specifike ishin përcaktuar për të ndërtuar rritjen e kapacitetit të stafit vendor. I gjithë stafi e ka arritur këtë përmes qasjes së barabartë në trajnim dhe mundësive për zhvillim personal të të punësuarve duke filluar me ata që punonin në administratë dhe udhëheqje deri te juristët e caktuar për përpunimin e rasteve. Personelit i ishin besuar përgjegjësi dhe mbështetje në rolet e tyre përmes monitorimit, vlerësimit të rregullt të paraqitjes dhe këshillimit. Kapaciteti i stafit është ndërtuar duke u mundësuar trajtimi i çështjeve komplekse dhe duke mbajtur takime mes stafit vendor dhe ndërkombëtar të cilat janë shfrytëzuar për shkëmbimin e informatave, duke marr vendime të përbashkëta dhe duke ju ofruar mundësi të merren me çështjet komplekse të cilat rrjedhin nga të dy kërkesat dhe çështje të programit.

Kapaciteti gjithashtu është ndërtuar përmes trajnimeve përmes së cilave HPD/KPA ka shfrytëzuar shërbimet e Universitetit vendor për t'u ofruar udhëzime personelit udhëheqës në lidhje me sferën e gjerë të çështjeve udhëheqëse. Janë organizuar pushime pune që organizohen çdo vit për anëtarët kyç të personelit duke u fokusuar në nacionalizimin e funksioneve mbikëqyrëse të KPA-së.

Suksesi në ndërtimin e kapacitetit ia ka mundësuar KPA-së që të vazhdojë me dhënien vendorëve të pozitave kyçe të udhëheqjes, kështu që në dhjetor të vitit 2006 rreth 14 nga 21 njësitet brenda KPA-së (66,7%) udhëhiqeshin nga stafi vendor. Gjashtë njësi (28.5%) udhëhiqeshin nga femrat.

Në vitin 2006, ishin shpenzuar gjithsej 3,085,024 milion euro për paga.

Shpenzimet e personelit për vitin 2006 (shifrat e konsoliduar për HPD dhe KPA):

<i>Stafi me BKK</i>	EUR	148,435
---------------------	-----	---------

Stafi me UNOPS

Stafi vendor	EUR	1,315,713
--------------	-----	-----------

Stafi ndërkombëtar	EUR	968,871
--------------------	-----	---------

Të caktuar nga UNMIK-u	EUR	358,255
------------------------	-----	---------

Të caktuar nga Norvegjia	EUR	293,750
--------------------------	-----	---------

Shpenzimet e përgjithshme për personelin: EUR		3,085,024
--	--	------------------

KAPITULLI 6

AKTIVITETET PËR INFORMIM & SHPËRNDARJA E INFORMATAVE PUBLIKE

KPA-ja gjatë tërë vitit 2006 ka vazhduar me përpjekjet e HPD-së për informimin e publikut. Ka ndërmarr disa iniciativa që të jetë më e pranishme për palët në kërkesë, OJQ-të, organizatat vendore dhe ndërkombëtare si dhe publikut në tërësi.

Ka ruajtur shërbimet e veta të Qendrës për Informata Telefonike dhe linjat e dedikuara telefonike ashtu që palët në kërkesat për pronë të banimit të mund të informohen me shpejtësi për statusin momental të kërkesës së tyre dhe mund të bëhen marrëveshjet për shërbime të shpejta dhe implementimin e vendimeve të HPCC-së. Gjithashtu shërben për

ofrimin e informatave paraqitësve të kërkesave të cilët kërkojnë informata mbi procedurën e paraqitjes së kërkesave për tokën dhe pronën komerciale sipas mandatit të ri të KPA-së.

Agjencia mbante dy ueb faqe (www.hpdkosovo.org për kërkesat e HPD-së dhe www.kpaonline.org për kërkesat e KPA-së) për të siguruar kushte për shkallë të gjerë të informatave dhe statistikave në aktivitetet e veta si dhe në implementimin e mandatit të vet. Kjo gjithashtu përbënte një mjet për kërkim përmes së cilit paraqitësit e kërkesave të HPD-së do të mund të siguronin statusin më të ri të kërkesës së tyre apo shkarkimin e vendimit përkitazi me kërkesën e tyre.

Në fillim të vitit 2006, rreth 1,541 paraqitës të kërkesave në HPD nuk kanë mundur të kontaktohen pasi që ata kishin ndërruar vendbanimin pa njoftuar HPD-në për të përditësuar detajet kontaktuese. Si rezultat kërkesat e tyre nuk kanë mundur të zgjidhen pasi që informatat e domosdoshme nuk ishin siguruar nga ata për procedim apo implementimin e kërkesës së tyre. Me qëllim të adresimit të kësaj situate në fillim të vitit 2006 HPD-ja kishte lëshuar një numër të shpalljeve publike, përmes mjeteve të informimit publik në Prishtinë dhe Beograd, në ueb faqet e veta si dhe përmes OJQ-ve të cilat punojnë me personat e zhvendosur duke kërkuar që paraqitësit e kërkesave të cilët nuk mund të gjendeshin ta kontaktojnë HPD. Në fund të vitit 2006 ende ishin rreth 1,159 paraqitës të kërkesave të cilët nuk mund të gjendeshin. Është menduar që kjo ka të bëjë me personat të cilët vullnetarisht kishin hequr dorë nga pronat e tyre, kështu që nuk kanë interes të mëtutjeshëm në procedurat juridike të paraqitura në HPD apo në shërbimet e saj të zbatimit (për të marr riposëdimin e pronës së tyre apo për ta vënë nën administrim).

HPD-ja apo KPA-ja e tanishme kanë lobuar aktivisht dhe janë përkrahur fuqishëm gjatë gjithë vitit 2006 në mbështetje nga autoritetet vendore për implementimin e mandatit të saj. Ishte nënvizuar se parakushti i domosdoshëm për përfundimin e shpejt të përmbushjes së mandatit të saj mund të arrihej në bazë të mbështetjes publike të procesit nga liderët dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Me qëllim që institucionet dhe autoritetet vendore dhe ndërkombëtare të pajisen me informata, HPD/KPA është takuar rregullisht me aktorët tjerë në fushën e të drejtave pronësore me qëllim të njoftimit sa më të mirë mbi punën e tyre dhe rëndësinë e saj në ndërtimin e paqes, zhvillimit ekonomik dhe sundimit të ligjit. Gjithashtu rregullisht është takuar me zyrtarët nga IPVQ dhe autoritetet e zbatimit të ligjit (policinë e UNMIK-ut, Shërbimin Policor të Kosovës dhe KFOR-in) me qëllim të rishqyrtimit të shkallës së nevojshme të mbështetjes për zbatimin e urdhrave për dëbim.

Me qëllim të kontaktimit të komunitetit minoritar nga i cili rreth 93.4% nga numri i përgjithshëm i kërkesave për pronë të banimit janë paraqitur në HPD, HPD/KPA është takuar rregullisht me udhëheqësin e lartë në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Në përpjekjet e veta gjithashtu ka përfshirë etnitetet që gjenden në Beograd, ku përfaqësuesit e HPD-së/KPA-së janë takuar me përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme të Qeverisë, OJQ-të, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare. Më tutje, zyrtarët nga HPD/KPA rregullisht kanë ndjekur dhe kanë marr pjesë në takimet dhe trajnimet në Kosovë dhe Serbia, të cilat ishin organizuar nga organizatat dhe OJQ-të e përfshira në çështjet përkatëse të së drejtave pronësore dhe në procesin e kthimit.

HPD/KPA është përfaqësuar dhe i ka raportuar rregullisht Grupit Punues mbi Standardet e të Drejtave Pronësore, i bashkë-kryesuar nga IPVQ dhe OSBE-ja e cila ka mandatin të monitorojë implementimin e standardeve mbi të drejtat pronësore në Kosovë.

Më tutje, mjetet kryesore në përmbushjen e mandatit të KPA-së ka qenë ndarja e ekspertizës dhe bashkëpunimi me grupet e tjera të interesuara në fushën e të drejtave pronësore. KPA-ja ishte shumë aktive gjatë viteve të kaluara në rritjen e bashkëpunimit dhe dialogut me disa institucione vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë siç janë UNDP, Zyrës së UNMIK-ut për Komunitete dhe Kthim, UNHCR, Këshillit Danez për Refugjatë, Këshillit Norvegjez për Refugjatë, Bankës Botërore, OSBE dhe BE. HPD/KPA gjithashtu ka punuar për së afërmi me UNDP në lidhje me përgatitjen e informatave që kanë ët bëjnë me vendimet e HPCC-së mbi pronat e shkatërruara për t'ia lehtësuar UNDP-së zbatimin e projekteve për rindërtim kudo nëpër Kosovë.

KPA, HPD e mëparshme, ishte ftuar të merr pjesë në konferencën ndërkombëtare mbi zgjidhjen e kontesteve pronësore në vendet me mjedis pas konfliktit e cila është mbajtur në Tajlandë në gusht 2006. Konferenca ishte organizuar nga Qendra mbi të Drejtat e Banimit dhe Dëbimet (COHRE) dhe pjesëmarrësve u ka ofruar platformën për të shpërndarë përvojën e tyre në fushën e zgjidhjes së kontesteve pronësore.

Me qëllim të nxjerrjes në pah të punës së saj dhe transformimin e HPD-së në KPA, një numër i buletineve informative dhe mesazheve janë shpërndarë gjatë vitit 2006 në tërë Kosovën, Serbi, Mal të Zi dhe IRJM. Në mesin e pranuesve janë përfshirë edhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare, etnitetet qeveritare, zyrat ndërlidhëse diplomatike, OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, gjykatësit, avokatët, prokurorët, media vendore dhe ndërkombëtare, institucionet arsimore dhe organet tjera të interesuara.

Gjatë gjithë vitit, KPA-ja ka shfrytëzuar fuqishëm praninë e mediave. Përfaqësuesit e KPA-së kanë dhënë mbi dyzet (40) intervista për gazetatat, radio stacionet dhe stacionet televizive dhe konferenca për shtyp për çështjet që kanë të bëjnë me pronën. HPD gjithashtu u ka ofruar mediave informata dhe statistika të rregullta dhe të përditësuara mbi aktivitetet dhe linjën e veprimit të vet përmes Njësitit të saj për Informim.

KPA – Fushata e informimit publik

Grupi i caktuar i paraqitësve të kërkesave në KPA në vitin 2004 nga raporti i pavarur i EAR-it - me mandat këshillues, është vlerësuar të jetë diku rreth 11,000 që kanë rrjedhur nga konflikti në Kosovë i vitit 1999. Fushata ajrore informative përtej kufinjëve ka nisur në vjeshtë të vitit 2006 për të informuar publikun mbi procesin e KPA-së dhe mundësisë për të paraqitur kërkesat. Fushata, e cila do të vazhdojë gjatë tërë shkurtit dhe marsit të vitit 2007, do të organizohet përmes publikimit në media, informatave online (www.kpaonline.org),⁵² shpalljet në gazetatat ditore, afishe, TV dhe radio reklamave dhe debateve. Gjithashtu do të përfshihen intervistat me media dhe etnitetet kyçe në fushën e së drejtës pronësore, takime me bashkësi, komunikimi me shoqata dhe OJQ që punojnë

⁵² Ueb faqja e KPA-së është lëshuar në përdorim në Prill 2006 në www.kpaonline.org dhe ofron statistika të freskëta mbi pranimin e kërkesave dhe mbi procesin dhe procedurat e KPA-së.

me personat e zhvendosur dhe refugjatë, të cilat të gjitha janë caktuar për të promovuar informimin e publikut për Agjencinë dhe mandatin e saj.⁵³ Fushata do të informoj publikun dhe aktorët kyç në fushën e të drejtave pronësore për procesin e KPA-së dhe si dhe ku të paraqesin kërkesat.

KAPITULLI 7

FONDET

7.1 HPD

Puna e HPD-së ishte mundësuar dhe mbështetur përmes përkrahjes së vazhdueshme të donatorëve të saj, kryesisht duke dhënë fonde qeveritë individuale të cilat përbëjnë 60% të kontributeve të përgjithshme. UNMIK-u dhe Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK) ka mbuluar 12% gjegjësisht 28% të buxhetit vjetor.

Donacionet e përgjithshme për HPD-në:

Donatori/viti		2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006 (6 muaj)	Totali (US\$)	% e totalit
1. UNMIK	BKK	745,000	490,000	770,000	1,235,000	1,340,000	1,200,000	550,000	6,330,000	31.2
	Rroga punëtorëve të caktuar	0	0	54,000	550,000	465,000	465,000	300,000	1,834,000	

⁵³ Kjo do të përfshij përshkrimin e procesit të KPA-së në Gjermani, Slloveni, Zvicër, Austri dhe në vendet tjera ku qëndron një numër i madh i popullatës së zhvendosur.

2. Norvegjia	Të dhuruara	185,000	0	310,000	1,170,000	240,000	660,000	0	2,565,000	14.5
	Rroga punëtorëve të caktuar	0	0	130,000	510,000	410,000	41,000	150,000	1,241,000	
3. Zvicra		0	500,000	1,800,000	400,000	180,000	500,000	0	3,380,000	12.9
4. EAR		0	0	1,835,000	0	650,000	490,000	0	2,975,000	11.4
5. Holanda		0	0	0	1,200,000	230,000	1,230,000	0	2,660,000	10.2
6. SHBA		0	0	230,000	0	1,000,000	500,000	0	1,730,000	6.6
7. Kanada		880,000	320,000	377,000	0	0	0	0	1,577,000	6.0
9. Finlanda		0	860,000	0	0	0	0	0	860,000	3.3
9. Gjermania		215,000	215,000	0	0	0	200,000	0	630,000	2.4
10. Irlanda		162,000	255,000	0	0	0	0	0	417,000	1.6
TOTALI		2,187,000	2,640,000	5,506,000	5,065,000	4,515,000	5,286,000	1,000,000	26,199,000	100
% e totalit		8.3	10.1	21.0	19.3	17.2	20.2	3.8	100	

Nga fillimi i saj prej vitit 1999 deri në dhjetor 2006, shpenzimet e akumuluar të operimit të HPD-së llogariten 26 milion \$ amerikan. Kjo barazohet me vlerën mjaft ekonomike prej 898\$ amerikan për secilën kërkesë të proceduar në tërësi, përfshirë mbledhjen e kërkesave, procedimin, vendimmarrjen, rishqyrtimin dhe implementimin, së bashku me planin e përgjithshëm institucional, skemën e pronës së administruar dhe politikën dhe aktivitetet këshilluese.

Kostoja e efikasitetit të operimit të HPD-së është bërë evidente kur është bërë krahasimi me koston e shërbimeve të ngjashme juridike dhe zgjidhjen e kërkesave në gjykatat e Kosovës. Shkalla e tarifës për shërbime juridike dhe të dhënat e gjykatës janë dhënë më poshtë në skemën e tarifave mbi Pagesën dhe Kompensimin e shpenzimeve të gjykatësve të lëshuar nga Bordi Ekzekutiv i Zyrës Kosovare të Avokatëve. Skema e tarifës cakton normën për krahasimin e paraqitjeve në procedurat civile prej 280\$ amerikan deri 370 (tarifa nr. 7). Kostoja e seancës gjyqësore është 90\$ amerikan, plus 30% (29\$ amerikan) për orë. Bazuar në këtë shkallë të tarifës, 892\$ amerikan, e cila ka mbuluar koston e tërësishme të procedimit dhe zgjedhjes së kërkesës në HPD, do të mund të mbulohej vetëm mbushja e kërkesës në gjykatë dhe më pak se 15 orë të punës plotësuese, duke përjashtuar tarifat e gjykatës. Kjo kohë nuk do të ishte e mjaftueshme për zgjidhjen e kërkesës për pronën e banimit.

7.2 KPA

Gjatë tërë vitit 2006 KPA ka paraqitur propozime të detajuara për 2007-2009, të cilat përballojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive implementimin e mandatit të saj. Kostoja e vlerësuar e projektit për aktivitetet e KPA-së janë si në vijim (shumat në €):

Pranimi i ankesave	350,000
Fushata e informimit publik	
Vendor	650,000
Ndërkombëtar	<u>350,000</u>
	1,000,000
Veturat	150,000
Pajisjet/Komunikimet/TI-ja	250,000
Operacionet	6,000,000
Personeli	7,000,000
Totali	<u>14,750,000</u>

Në fund të vitit 2006, KPA ka pranuar premtimet nga donatorët për procesin si në vijim (shuma në €):

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (i kufizuar vetëm për shpenzimet në Kosovë – 3 vite) përafërsisht	3,000,000
Agjencia Evropiane për Rindërtim (i kufizuar vetëm për shpenzimet në Kosovë dhe personelin për një vit)	3,000,000
Zvicra (mbi 3 vite 2006-2008) ¹¹	1,000,000
UNMIK (1 vit në formën e kontributit me 2 profesionist ndërkombëtarë dhe 6 vullnetarë të KB)	660,000
Britania e Madhe (një vit)	500,000

¹¹ € 300,000 në pritje të aprovimit parlamentar të buxhetit për vitin 2008.

SHBA-ja 270,000

Norvegjia
(në formën e kontributit më tre profesionist për një vit) 250,000

Totali €8,680,000

Deficiti €6,070,000

Në nëntor të vitit 2006, KPA-ja, në konsultim me ZPSSG, si Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, ka organizuar takim të donatorëve për ta informuar komunitetin e donatorëve për mandatin dhe statusin e KPA-së. Pjesëmarrësve në Konferencë u ishte ofruar pakoja e informatave ku jepeshin detaje për planin e veprimit për implementimin e mandatit të KPA-së; është relevante të ndërtohet paqja dhe rilindja ekonomike e Kosovës, së bashku me koston e vlerësuar të operimit të përgjithshëm. Informatat relevante në paraqitjen e synimeve gjithashtu ishin ofruar së bashku me përkushtime të prera për dorëzim të pavarur.

KAPITULLI 8

NGJARJET KYÇE GJATË VITIT 2006

- Në mars 2006 UNMIK-u ka shpallur Rregulloren 2006/10 për Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e cila HPD-në e transformon në Agjenci të re, KPA dhe i jep mandatin të zgjidhë kërkesat që kanë të bëjnë me tokën dhe pronën komerciale, si plotësim i mandatit të saj ekzistues për pronat e banimit. HPD e cila ishte transformuar në KPA ka pushuar së ekzistuari.
- Në prill 2006, z. Jean Dussourd, ish Udhëheqësi i Shtyllës së Parë të UNMIK-ut, Policisë dhe Drejtësisë, zyrtarisht ka nisur veprimet për pranimin e kërkesave të KPA-së në takimin publik në Mitrovicë.

- Në prill 2006, Drejtori i KPA-së është takuar me Kryeministrin sapo emëruar të IPVQ-së, z. Agim Çeku, me qëllim ta informoj atë me mandatin dhe funksionet e agjencisë së re të formuar, KPA-së. Z. Çeku bëri të ditur rëndësinë e kontributit të dhënë nga procesi i ish HPD-së për të përmbushur standardet mbi të drejtat pronësore duke premtuar mbështetjen e tij të plotë dhe të Qeverisë së Kosovës për procesin e KPA-së.
- Në prill 2006 PSSP-ja ka aprovuar implementimin e skemës së qirasë për pronat nën administrimin e HPD-së/KPA-së, e cila më vonë në gusht është nënshkruar nga IPQV.
- Në maj 2006 Qeveria e Norvegjisë ka konfirmuar mbështetjen e saj duke vazhduar marrëveshjet ekzistuese për të punësuarit, për tre jurist ndërkombëtarë gjatë vitit 2006.
- Në korrik 2006, si pjesë e orvatjeve të vazhdueshme për të siguruar implementim të patrazuar dhe efektiv të mandatit të KPA-së, UNMIK-u dhe UNOPS-i kanë nënshkruar ndryshimin e marrëveshjes së vitit 2002 të nënshkruar me HPD, me të cilën UNOPS-i ka ndërmarr vazhdimin e shërbimeve të ngjashme në KPA.
- Në korrik 2006 Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER) publikisht i ka premtuar 3 milion euro për veprimtarin e KPA-së. Projekti konsiderohet si parakusht për krijimin e klimës së investimeve, duke stimuluar ekonominë e përgjithshme, duke mundësuar zbatimin e ligjit, promovimin e kthimit të qëndrueshëm dhe rritjen e mundësive të zhvillimeve ekonomike për komunitetet pakicë.
- Në korrik 2006, në takimin përurues të mbajtur nga Bordi Mbikëqyrës i KPA-së, z. Steven Schook, ZPSSP dhe Kryetar i Bordit të përbërë nga anëtarët sipas

- Në shtator 2006, Qeveria e Britanisë së Madhe ka premtuar 500,000 euro për procesin e KPA-së kurse Qeveria e SHBA ka premtuar 270,000 euro.
- Në tetor 2006, UNMIK-u ka shpallur Rregulloren 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale, e cila ka bërë disa ndryshime vendimtare për procesin e vendimmarrjes mbi kërkesat, në lidhje me procedurat e miratimit, e cila do të sigurojë zgjidhjen e shpejt të të gjitha kërkesave.
- Në tetor 2006, KPA në konsultim me anëtarët e HPCC-së, Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut dhe Zyrën e Këshilltarit Ligjor, ka përgatitur dhe ka paraqitur draftin e Urdhëresës Administrative për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/10, të ndryshuar me Rregulloren 2006/50, duke përcaktuar rregullat e detajuara mbi procedurën e mbledhjes, procedimit, vendimmarrjes dhe implementimit të kërkesave.
- Në nëntor 2006, KPA-ja ka mbajtur takim publik Donatorësh, në të cilin është kërkuar mbështetja për procesin e KPA-së, ku Qeveria Zvicrane premtoi një milion euro për procesin e KPA-së. KPA-ja nisi kampanjën gjithëpërfshirëse katër mujore për informimin e publikut.
- Në dhjetor 2006, Qeveria Norvegjeze konfirmoi mbështetjen e saj duke e zgjatur angazhimin e tre juristëve ekzistues ndërkombëtarë të caktuar edhe për gjashtë muaj.

- Në dhjetor 2006, KPA ka konsoliduar zyren e vet qendrore në rr. Nazim Gafurri nr. 1 në Prishtinë (paraprakisht gjendeshin në rr. Goleshi nr. 2 dhe rr. Bashkim Vllaznimi nr. 51).

VLERËSIMI I PAVARUR

Në vitin 2006 Qeveria e Norvegjisë ka vazhduar vlerësimin e pavarur të operacioneve të HPD-së i cili kishte filluar në nëntor 2005. Përfaqësuesit e Qeverisë së Norvegjisë kanë udhëtuar në Beograd dhe në tërë Kosovën duke dhënë udhëzime të detajuara dhe dokumentacion mbështetës mbi praktikën dhe procedurat e HPD-së, vendimet e Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (HPCC), ligjet në fuqi që udhëheqin procedurat e HPD/HPCC-së duke mbajtur takime me udhëheqësinë dhe personelin e HPD-së. Ata gjithashtu janë takuar edhe me palët e jashtme siç janë UNMIK-u, OSCE, IPVQ dhe aktorët e tjerë kyç në fushën e të drejtave pronësore. Qëllimi kryesor i vlerësimit ishte të diskutojë për rezultatin e HPD-së për aq sa i takon implementimit të mandatit të saj për pronën e banimit dhe të vlerësojë ndikimin e saj në Kosovë dhe në rajon si tërësi.

Raporti i vlerësimit i publikuar në tetor të vitit 2006 ka konstatuar se korniza rregullative e HPD/HPCC kishte cilësitë e nevojshme për të zgjidhur kontestet pronësore në mënyrë të drejtë dhe efikase. Ai po ashtu ka konstatuar se procedurat dhe praktikrat e saja kanë përfshirë parimet e procedurave të drejta dhe përpunimin e lëndëve si dhe respektonin në përgjithësi standardet e të drejtave njerëzore të njohura.

Ai ka konstatuar se institucioni ka luajtur një rol qenësor për të sjellur drejtësi për popullatën pakicë në Kosovë dhe ka fituar reputacionin e të qenit i paanshëm, falë implementimit të mandatit të vet në mënyrë objektive dhe neutrale, e pavarur nga politika dhe rrethanat tjera. Raporti po ashtu ka konstatuar se përmes procesit të HPD/HPCC-së është mundësuar nxjerrja e mësimave të vlefshme si në kontekstin e trajtimit të sfidave lidhur me të drejtat pronësore në një ambient pas konfliktit si dhe lidhur me përcaktimin dhe planifikimin e mekanizmave ligjore për zgjidhjen e kontesteve

pronësore. Ai ka konstatuar se këto mësimë padyshim do të jenë të çmueshme në formulimin e politikës dhe përcaktimin e mekanizmave në përpjekje për të zgjidhur sfidat e të drejtave pronësore në të ardhmen në ambientet pas konfliktuale.¹²

¹² Raporti i vlerësimit mund të gjendet në <http://www.humanrights.uio.no/forskning/publ/nr/2006/1206.pdf>

KAPITULLI 9

VITI PARA NESH

9.1 Vendimmarrja dhe implementimi i kërkesave për prona të banimit

HPCC-ja do të shqyrtojë 335 kërkesat për rishqyrtim që janë në pritje në seancat vijuese dhe këto kërkesa do të implementohen për një kohë sa më të shkurtër.

KPA-ja do të kryejë implementimin e 721 kërkesave që kanë mbetur për prona banimi në muajt vijues. Ajo do të implementojë skemën mbi kompensimin të siguruar përmes nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 me qëllim të sigurimit që 258 urdhrat e HPCC-së për aprovimin e të drejtave pronësore dhe kompensimin të jenë përfunduar dhe implementuar.

9.2 Pranim-dorëzimi i dosjeve të lëndëve të kryera për prona banimi

Që nga vjeshta e vitit 2005, HPD/KPA-ja ka qenë e kyçur në përgatitjen e pranim-dorëzimit të dosjeve të kërkesave të kryera të HPD-së tek autoritetet vendore duke synuar sigurimin e regjistrave për të gjitha lëndët. Ajo ka mbajtur takime dhe lidhje me gjykatat komunale, Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut si dhe Ministrinë e Drejtësisë për të siguruar përgatitjet e nevojshme në lehtësimin e këtij procesi. Kjo përfshinë edhe atë që marrësit të jenë të përgatitur nga ana logjistike për të pranuar volumin e madh të dosjeve të kërkesave si dhe kryesisht të jenë kompetent për shfrytëzimin e dosheve në të ardhmen.

KPA-ja është duke i riprodhuar në mënyrë digjitale të gjitha dosjet me qëllim të ofrimit të kopjeve elektronike të dosjeve të mundshme për autoritetet vendore, UNMIK-un dhe subjektet tjera të identifikuar nga PSSP-ja. Pranim-dorëzimi i dosjeve do të përkojë me përfundimin e mandatit të kërkesave të banimit.

9.3 Kërkesat për toka bujqësore dhe prona komerciale

KPA-ja do të punojë për të siguruar një zgjidhje efektive dhe të shpejtë të 11,000 kontesteve përkitazi me pronat private të paluajtshme, përfshirë tokën bujqësore dhe komerciale, që janë rrjedhojë e konfliktit të armatosur të vitit 1999. Me qëllim që kjo të arrihet, ajo do të vazhdojë që të pranojë kërkesa mbi toka dhe prona komerciale. Ajo do t'i përpunojë këto kërkesa dhe do t'ia paraqes për shqyrtim Komisionit për Kërkesa Pronësore. Urdhëresa Administrative, që i përcakton hollësisht rregullat e procedurës dhe dëshmitë relevante të përpunimit, shqyrtimit dhe implementimit të kërkesave, do ta vë procesin në funksion dhe kjo parashihet të nxirret në fillim të vitit 2007. KPA-ja do të vazhdojë të administrojë pronat që janë nën administrimin e saj dhe do të sigurojë në përmirësimin e skemës mbi qiranë në tërë Kosovën lidhur me këto prona.

Menaxhmenti i KPA-së i ka vënë vetes synime ambicioze sa i përket produktivitetit për vitin 2007 si dhe atë vijues. Është paraparë që procesit të KPA-së do t'i nevojiten tri vite për të vepruar. Synimet e produktivitetit, varësisht nga fondet që do të mundësohen, janë projektuar si në vijim:

Periudha/ Afati kohor	Veprimtaria
mars 2007	Pranimi i 11,000 kërkesave të parapara
	Paraqitja e 2,000 kërkesave të përpunuara pranë KPCC-së për shqyrtim
	Kontaktimi dhe dërgimi i informatave të të gjithë paraqitësve të kërkesave, ku KPCC-ja ka marrë vendime për kërkesat e tyre
dhjetor 2007	KPCC-ja vendos mbi të gjitha 11, 000 kërkesat e pranuar
	Kontaktimi dhe dërgimi i informatave të të gjithë paraqitësve të kërkesave, ku KPCC-ja ka marrë vendime për kërkesat e tyre
dhjetor 2008	Implementimi i të gjitha vendimeve
mars 2009	Përfundimi i pranim-dorëzimit të shënimeve të autoritetet vendore
qershor 2009	Likuidimi i KPA-së

SHËNIM PËRMBYLLËS

Iniciativa e HPD-së ka dëshmuar se ka qenë sukses shumë i madhë, pasi që vendimet në të gjitha 29,160 lëndët mbi pronat e banimit janë lëshuar dhe u janë dërguar palëve në kërkesë. Ajo ka ofruar një forum të arritshëm, të drejtë, të lirë dhe të shpejtë në zgjidhjen e këtyre kontesteve pronësore. Kryerja e sasisë së madhe të lëndëve ka dhënë kontribut të çmueshëm si në idealet e përkrahura nga Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 po ashtu edhe në rehabilitimin pas konfliktit si dhe në ndërtimin e paqes. Ajo me efikasitet ka shqyrtuar humbjen e së drejtave pronësore të nxjerrura në pah, për shkak të diskriminimit etnik dhe zhvendosjes masive të popullatës. Është mirë e njohur se ngjarje të tilla, nëse mbeten të pashqyrtuara, vazhdojnë të shkaktojnë trazira sociale dhe tensione etnike që shpiejnë në dhunë dhe trazira të mëtejme. Në përgjithësi, procesi kishte efekt spin off pozitiv në rehabilitimin pas konfliktit si dhe në promovimin e ngritjes ekonomike dhe të prosperitetit për të gjithë popullatën e Kosovës.

Përvoja e HPD/HPCC-së qartë ka demonstruar se zgjidhja e kontesteve pronësore është plotësisht e arritshme nëse gjendet mekanizmi i duhur i cili është i pajisur me veglat e nevojshme që ndihmjnë efikasitetin optimal në zgjidhjen dhe implementimin e vendimeve. KPA-ja e ka potencialin për tu ngritur më lartë bazuar në këtë përvojë lidhur me zgjidhjen e kërkesave mbi pronat private të paluajtshme, përfshirë tokën dhe pronat komerciale.

Përmes përcaktimit të mekanizmave të HPD-së dhe KPA-së për zgjidhjen e kontesteve pronësore, e drejta për kthim të së drejtës pronësore për personat e zhvendosur që është përshkruar si *‘një përpjekje e cila mbetet një plan për një afat kohor më të gjatë’*¹³ në fakt është bërë realitet për refugjatët e Kosovës si dhe personat e zhvendosur. Kthimi i pronës së banimit ka përfunduar duke dhënë një precedent historik dhe HPD-ja është

¹³ Leckie, S., *“Kthimi në shtëpi: Kthimi i të drejtave pronësore banesore i refugjatëve dhe personave të zhvendosur”*, botuesit transnacional, New York, 2003.

cilësuar si model për zgjidhjen e kontesteve pronësore me skenar krejt ndryshe nga Iraku, Gjeorgjia dhe Palestina, ndërmjet tjerash.¹⁴

¹⁴ Shiko për shembull raportin e vlerësimit norvegjez që mund të gjendet në <http://www.humanrights.uio.no/forskning/publ/nr/2006/1206.pdf>.

ANEKSI 1

ANËTARËT E KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE PRONËSORE DHE BANESORE

Z. Alan Dodson (Afrika e Jugut) është Kryesues i HPCC-së dhe gjendet në këtë pozitë prej themelimit të saj. Është i diplomuar në Universitetin Natal dhe ka magjistruar në Universitetin Cambridge. Ka qenë avokat në Gjykatën e Lartë të Afrikës së Jugut prej vitit 1985-1995 dhe Gjykatës në Gjykatën për Kërkesa të Tokës në Afrikën e Jugut prej vitit 1995-2000, ndërkohë që ka kryesuar Komitetin për Hartimin e Ligjeve Pyjore. Për momentin kryeson Këshillin Mbikqyrës Kombëtar për Pyje në Afrikën e Jugut. Është avokat në Gjykatën e lartë të Afrikës së Jugut, ku specializon në ligjin mbi prona, ligjin kushtetues dhe atë administrativ. Ai është ekspert botëror në zgjidhjen e kontesteve pronësore në shoqëritë në tranzicion dhe ka botuar disa artikuj mbi të drejtat e banimit, ligjin mbi ambientin dhe tema të ngjashme.

Z. Veijo Heiskanen (Finlandë) është anëtar ndërkombëtar i panelit të HPCC-së. Është i diplomuar në Universitetin e Helsinkut dhe Shkollës Juridike të Harvardit; ai ka magjistruar në vitin 1988 dhe ka doktoruar në vitin 1992. Ai ka specializuar në ligjin ndërkombëtar; ligji mbi gjykimin komercial, ligjin mbi tregtinë dhe atë mbi internetin. Para pozitës në Lalive & Partners në Gjenevë, ka shërbyer si Sekretar i Përgjithshëm dhe Gjykatës i Lartë i Tribunalit për Zgjidhjen e Kërkesave për Llogaritë e Papërdorura në Zvicër (2001-2002); Drejtor i Institutit Ekonomik Ndërkombëtar Ligjor në Universitetin e Helsinkut (1998-2000); Zëvendës-shëf i Shërbimeve Ligjore të Komisionit të KB-së për Kompenzim (1994-1998); dhe Këshilltar Ligjor për Tribunalin e Kërkesave Iran-SHBA në Hagë (1990-1994). Ka ligjëruar në institucione të ndryshme, përfshirë Universitetin e Helsinkut dhe në Akademinë e të Drejtës Ndërkombëtare në Hagë; ka qenë profesor vizitues në Universitetin e KB-së në Tokio (1999); ka punuar për Komisionin e Arbitrimit të konferencës Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (1993); dhe po ashtu ishte anëtar i Komitetit Drejtues për Proceset Kolektive të Kërkesave Ndërkombëtare në Gjykatën e Përhershme të Arbitrimit. Është autor i disa botimeve mbi të drejtën ndërkombëtare ; arbitrimin ndërkombëtar dhe zgjidhjen e kontesteve.

Z. Aqif Tuhina (Kosovë) është anëtar vendor i panelit të HPCC-së. Ka diplomuar në drejtësi në vitin 1964 në Universitetin e Beogradit. Para se të punojë si avokat, ka shërbyer si Gjykatës në Kosovë, edhe në Gjykatën e Punës po ashtu edhe në Gjykatën Supreme para se Kosova ta humbë autonominë në vitin 1989. Së voni ka punuar për Sekretariatit Krahinor të Kosovës për Legjislacion si dhe me Departamentin e UNMIK-ut për Çështje Gjyqësore. Është specialist në patundshmëri dhe në të drejtën kriminale.